RAPORTI I VITIT 2012 MBI TË DREJTAT E NJERIUT NË KOSOVË

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Kosova është demokraci parlamentare. Kushtetuta dhe ligjet parashikojnë kompetencat dhe përgjegjësitë e Kuvendit njëdhomësh nacional të zgjedhur në mënyrë të lirë, të Qeverisë së miratuar nga Kuvendi dhe të Presidentit të zgjedhur nga Kuvendi. Kosova e shpalli pavarësinë në vitin 2008 pasi e pranoi Planin për Zgjidhje Gjithëpërfshirëse (PZGJ), i cili parashikon mekanizma të sponsorizuar ndërkombëtarisht, duke përfshirë Misionin e BE-së për Sundim të Ligjit (EULEX), për ta mbështetur Qeverinë. Periudha e mbikëqyrjes ndërkombëtare përfundoi më 10 shtator pasi Grupi Drejtues Ndërkombëtar deklaroi se vendi kishte bërë ose arritur përparim të madh në zotimet e veta për PZGJ. EULEX-i dhe Qeveria u pajtuan për zgjatjen e mandatit të EULEX-it deri në vitin 2014. Forcat e sigurisë u raportonin autoriteteve civile, me Forcën e Sigurisë së Kosovës (FSK), gjithashtu të monitoruar nga forca paqeruajtëse e NATO-s për Kosovën (KFOR) dhe EULEX-in që e monitoronte Policinë e Kosovës (PK) në një kapacitet të kufizuar.

Në problemet më të rëndësishme të të drejtave të njeriut gjatë këtij vit përfshiheshin barrikadat e vendosura në pjesën veriore të vendit nga ekstremistët serbë të Kosovës, duke kufizuar kështu të drejtat themelore, duke përfshirë lirinë e lëvizjes dhe qarkullimin e mallrave. Ekstremistët serbë gjithashtu përdorën dhunën dhe kërcënimin ndaj kundërshtarëve vendës dhe forcave ndërkombëtare të sigurisë gjatë vitit. Fusha e tretë e shqetësimit serioz ishte diskriminimi shoqëror ndaj bashkësive pakicë, personave me aftësi të kufizuara dhe anëtarëve të komunitetit të lesbikeve, homoseksualëve, biseksualëve dhe transgjinorëve (LHBT), si dhe dhuna në familje, posaçërisht ndaj femrave.

Në brenga të tjera për të drejtat e njeriut përfshiheshin korrupsioni dhe favoritizmi në burgje, paraburgimi i gjatë, joefikasiteti i gjyqësorit, kërcënimi ndaj medieve nga zyrtarët publikë dhe elementët kriminelë, përparimi i kufizuar në kthimin e personave të zhvendosur brenda vendit (PZHBV) në shtëpitë e tyre, korrupsioni në Qeveri, trafikimi i personave dhe puna e fëmijës në sektorin joformal.

Qeveria ndërmori masa për t'i ndjekur penalisht dhe dënuar zyrtarët që kryen abuzime, qoftë në shërbime të sigurisë apo gjetiu në Qeveri, ndonëse shumë veta mendonin që zyrtarët e lartë përfshiheshin në korrupsion dhe vepronin pa u ndëshkuar.

Seksioni 1. Respektimi i integritetit të personit, duke përfshirë lirinë nga:

a. Privimi arbitrar ose i paligjshëm i jetës

Nuk pati raportime që Qeveria apo agjentët e saj kryen vrasje arbitrare apo të paligjshme gjatë këtij viti.

Më 29 nëntor, Tribunali Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë i liroi ish-Kryeministrin Ramush Haradinaj dhe dy të tjerët për krime të luftës të kryera në një qendër ndalimi të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) në vitin 1998.

Njëri prej gjashtë personave të dyshuar për vrasjen në korrik të vitit 2011 të policit Enver Zymberi iu dorëzua autoriteteve më 7 qershor dhe u lirua më vonë nga gjykata. Autoritet nuk ndaluan të dyshuar të tjerë dhe EULEX-i vazhdoi ta hetonte këtë rast në fund të vitit.

Gjatë këtij viti, Qeveria bashkëpunoi me Task Forcën e EULEX-it për Hetime Speciale (SIFT), e cila u formua në vitin 2011, për t'i hetuar pohimet për abuzim të rëndë të kryer ndërmjet korrikut të vitit 1999 dhe mesit të vitit 2000 nga pjesëtarët e UÇK-së dhe bashkëpunëtorët e tyre. Abuzimi, të cilin e mbuloi një raport i Këshillit të Evropës, përfshinte kushte çnjerëzore të ndalimit dhe vrasje të civilëve për trafikim të organeve të tyre jashtë vendit. Hetimi i SIFT-it vazhdoi në fund të vitit.

Më 21 nëntor, Gjykata Supreme urdhëroi rigjykimin e anëtarit të Kuvendit, Fatmir Limaj, dhe tre të bashkëpandehurve, të cilët autoritetet i akuzonin për kryerje të krimeve të luftës kundër civilëve dhe të burgosurve politikë në qendrën e ndalimit në Kleçkë në vitin 1999. Gjykata e anuloi vendimin e 2 majit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë për lirimin e katër të pandehurve pasi kishte përcaktuar që një gjykatë tjetër nuk i kishte marrë parasysh më herët dhe i kishte trajtuar padrejtësisht ditarët dhe dëshminë e Agim Zogajt, i ndjeri ishte dëshmitar kryesor në këtë rast. Autoritetet i ndaluan të katërtit, të cilët mbetën në paraburgim në fund të vitit. Më 11 dhjetor, Gjykata Supreme gjithashtu riktheu akuzat kundër gjashtë të pandehurve të tjerë për të njëjtat krime mbi të njëjtën bazë. Këta të pandehur mbetën në arrest shtëpiak.

b. Zhdukja

Nuk pati raportime për zhdukje me motive politike.

Sipas Komitetit ndërkombëtar të kryqit të kuq, në fund të vitit, 1.766 persona ende gjendeshin në listën e personave të zhdukur që nga konflikti i vitit 1998-99. Prej këtyre, 70 për qind ishin shqiptarë të Kosovës dhe 30 për qind ishin serbë të Kosovës dhe pakica të tjera.

c. Torturimi dhe trajtimet apo ndëshkimet e tjera të egra, çnjerëzore apo poshtëruese

Kushtetuta dhe ligji ndalojnë praktika të tilla. Ndonëse monitorues ndërkombëtarë që e vizituan vendin në vitin 2010 gjetën që PK-ja përdori forma të abuzimit gjatë marrjes së deklaratave, që do të mund të konsideroheshin torturë, vëzhgues vendorë konkluduan së voni që nuk kishte torturë në institucione korrektuese. Nuk pati raportime që EULEX-i apo KFOR-i (i cili ka autoritet të kufizuar për arrestim dhe ndalim) përdorën forma të abuzimit.

Gjatë vizitës që i bëri vendit në vitin 2010, Komiteti i Këshillit të Evropës për Parandalimin e Torturës (KPT)) pranoi nga personat që ishin në burg apo ishin ndaluar kohët e fundit pretendime të shumta dhe të vazhdueshme për keqtrajtim fizik nga zyrtarët policorë të PK-së. Pretendimet kishin të bënin kryesisht me goditje me grushte, shqelma dhe shkopinj gjatë kohës së ndalimit. KPT gjithashtu raportoi se disa zyrtarë policorë përpiqeshin të merrnin deklarata nga

ta gjatë marrjes në pyetje duke i goditur me shuplaka, grushte, shqelma (duke përfshirë gjenitalet), duke i goditur personat me objekte të forta, duke ua shtypur dorën me laps të vendosur ndërmjet dy gishtave dhe duke i rrahur në tabanë të këmbëve. KPT vuri në pah se në disa raste ashpërsia e keqtrajtimit të supozuar ishte e tillë saqë "lehtë do të mund të cilësohej si torturë". KPT konkludoi se dukej që "gjendja sa i përket trajtimit nga Policia e Kosovës të personave të privuar nga liria ka stagnuar, nëse nuk është përkeqësuar" që nga vizita e vet në vitin 2007.

Në raportet e bazuara në vizitat e fundit, vëzhguesit vendorë, duke përfshirë Zyrën e Avokatit të Popullit dhe Qendrën e Kosovës për Rehabilitimin e Viktimave të Torturës (QKRVT), gjetën që tortura, siç përkufizohej në Konventën e OKB-së kundër Torturës, nuk ekzistonte në institucionet korrektuese të vendit dhe se ankesat e izoluara për keqtrajtimin e të burgosurve dhe të ndaluarve vazhdimisht kishin shënuar rënie viteve të fundit. QKRVT raportoi se numri i ankesave të izoluara gjatë vitit 2012 u ngrit paksa në krahasim me vitet e mëparshme. Zyra e Avokatit të Popullit raportoi se i kishte marrë 13 raporte se gardianët e burgut i kishin abuzuar të ndaluarit apo të burgosurit.

Më 14 janar, policia u përlesh me protestues shqiptarë të cilët përpiqeshin t'i ndalonin automjetet komerciale serbe për të mos hyrë në Kosovë. Protestuesit gjuanin gurë dhe tulla, duke lënduar disa policë. Policia përdori gaz lotsjellës, shkopinj gome dhe topa uji kundër turmës dhe arrestoi 162 protestues. Ndërsa raportet e medieve fillimisht raportonin për përmbajtje të policisë, disa grupe të shoqërisë civile, organizata ndërkombëtare dhe Avokati i Popullit pohuan që policia përdori dhunë të tepërt. Pati raportime se policia i arrestoi në mënyrë selektive në shtëpitë e tyre qytetarët që nuk kishin marrë pjesë në protestën e palejuar. Zyrtarët qeveritarë filluan hetimet për këto protesta dhe në mars publikuan gjetjet e veta që policia në përgjithësi kishte vepruar në mënyrë të matur, përveç në disa raste. Zyrtarët ia referuan ato raste individuale Inspektoratit Policor për masa të mëtejme.

Kushtet e burgjeve dhe të qendrave të ndalimit

Burgjet dhe qendrat e ndalimit në përgjithësi i plotësonin standardet ndërkombëtare; megjithatë, pati probleme të mëdha në disa institucione policore. Problemet përfshinin ndriçimin apo ventilimin e dobët në disa objekte, sistemet e prishura të nxehjes, furnizimin e pamjaftueshëm me ujë, dhunën ndërmjet të burgosurve, korrupsionin, mungesën e trajtimit adekuat mjekësor dhe objektet e vjetruara. Qeveria u lejoi vizita vëzhguesve të pavarur për të drejta të njeriut.

Kushtet fizike: Shërbimi Korrektues i Kosovës (SHKK) i udhëhoqi punët ditore në të gjitha qendrat korrektuese dhe të ndalimit. EULEX-i mbajti rol të kufizuar monitorues, mentorues dhe këshillues në burgje dhe i transportonte të burgosurit sipas kërkesës. Në fund të dhjetorit, sistemi i qendrave korrektuese pati 1.036 të burgosur të dënuar dhe 655 të paraburgosur të përzier në burgje dhe qendra të ndalimit. 48 femra dhe 45 të mitur ishin në burgje dhe qendra të ndalimit. Rrjeti i qendrave korrektuese mund ta përballojë një popullatë prej përafërsisht 2.000 personash.

Tri qendra korrektuese gjashtë qendra të ndalimit, një qendër për mbrojtje të dëshmitarëve dhe një spital i burgut punuan gjatë këtij viti.

QKRVT konkludoi se kushtet mbetën nën standarde në disa zona dhe në disa pjesë të objekteve, duke përfshirë ndriçimin apo ventilimin e dobët në disa qeli dhe kuzhinat, tualetet dhe shtretërit e vjetruar në disa burgje dhe qendra të ndalimit. Në shtator, QKRVT regjistroi probleme të veçanta në sistemin sanitar në Qendrën Korrektuese në Dubravë, që është objekti kryesor korrektues në vend, ku tualetet e thyera, sistemet jofunksionale të nxehjes dhe furnizimi i pamjaftueshëm me ujë mbetën probleme të vazhdueshme. Grupi konkludoi se sistemet korrektuese ofronin pak resurse adekuate mjekësore, gjë që rezultonte në trajtim mjekësor të pa ofruar apo të vonuar për kushte të shëndetit fizik apo mendor dhe vuri në pah që disa të burgosur nuk kishim marrë barëra për pesë muaj. Nuk pati raportime që të burgosurit nuk kishin qasje në ujë të pijshëm.

Duke raportuar për vizitën e vet të vitit 2010, KPT theksoi se kushtet fizike në stacionet policore të vendit ishin përmirësuar që nga vizita e vet në vitin 2007. Në veçanti, KPT theksoi se stacionet policore në Pejë, Leposaviq, Prishtina Nr. 1 dhe qelitë e qendrës së ndalimit në Prizren ishin në përgjithësi në gjendje të mirë dhe në Pejë, Prishtina Nr. 1 dhe Prizren, qasja në dritën natyrore në qeli ishte adekuate. Megjithatë, KPT raportoi për një sërë të metash në stacione të tjera policore, si në Mitrovicën veriore, ku qelitë mbetën të vjetruara, dhe në Leposaviq dhe në Mitrovicën veriore ku qelitë kishin vetëm dritë të kufizuar natyrore. Në Leposaviq, Pejë (vetëm në disa qeli) dhe Prizren, ndriçimi artificial ose nuk ekzistonte ose ishte jofunksional, dhe në Leposaviq dhe Pejë, tualetet në qelitë dyshe nuk ishin të ndara. Përveç kësaj, në Prishtina Nr. 1 nuk kishte ujë të nxehtë dhe disa dushe nuk punonin. KPT citoi pretendimet që të burgosurit kishin "punësuar" pjesëtarë të njësisë speciale të Dubravës për ndërhyrje për t'i sulmuar fizikisht të burgosurit e tjerë që u shkaktonin telashe. KPT gjithashtu konkludoi që dhuna ndërmjet të burgosurve, korrupsioni dhe favoritizmi ishin probleme "endemike" në Dubravë dhe institucione të tjera ndëshkimore.

Administrata: Autoritetet u lejonin të burgosurve qasje në vizitorë dhe ua lejonin ceremonitë fetare, duke përfshirë të drejtën për të kërkuar vizita të klerikëve. Burgjet dhe qendrat e ndalimit gjithashtu ofronin meny të modifikuara për ceremoni fetare, duke përfshirë agjërimet/kreshmët fetare.

Të ndaluarit mund t'u paraqitnin ankesa dhe kërkesa për hetime autoriteteve gjyqësore dhe Zyrës së Avokatit të Popullit, pa censurim, përmes kutive anonime në shumicën e burgjeve. Në fund të vitit, të burgosurit kishin parashtruar 114 ankesa përmes Avokatit të Popullit, 36 prej tyre kishin të bënin me çështje gjyqësore dhe 78 me çështje të ndryshme, pesë ankesa mbetën nën hetim.

Monitorimi: Zyrtarët korrektues lejuan vizita dhe monitorim të burgjeve dhe qendrave të ndalimit, por kërkuan nga disa organizata joqeveritare (OJQ) të njoftonin paraprakisht për vizita monitoruese. Zyra e Avokatit të Popullit dhe QKRVT-ja i inspektuan qendrat korrektuese dhe qendrat e ndalimit gjatë këtij viti. Monitoruesit raportuan për bashkëpunim të mirë nga shërbimi

korrektues gjatë vizitave, duke përfshirë mundësinë për të mbajtur intervista private me të burgosur.

Përmirësimet: Qeveria bëri disa përmirësime në tërë sistemin. QKK filloi përdorimin e një baze të dhënash për gjurmimin e të ndaluarve dhe të të burgosurve, duke gjurmuar 2.574 persona që nga koha kur baza e të dhënave u vu në linjë. QKK gjithashtu punoi për të siguruar që infermierët ishin në dispozicion në të gjitha qendrat korrektuese 24 orë në ditë.

Gjatë këtij viti Qeveria vazhdoi me ndërtimin e një burgu të ri të sigurisë së lartë në Podujevë, me kapacitet prej 300 të burgosurve.

Qeveria gjithashtu bëri përmirësime në objektin e Dubravës. EULEX-i i ndihmoi Qeverisë në instalimin e një sistemi televiziv me qark të mbyllur në tërë objektin për ta përcjellë më mirë dhunën ndërmjet të burgosurve dhe themeloi një sistem të ri të sigurisë për raportimin e incidenteve. Më 31 gusht, Ministria e Drejtësisë e shkarkoi drejtorin e burgut pas mbledhjes së një komisioni për t'i hetuar akuzat e vazhdueshme për korrupsion. Ministria i transferoi dy zëvendësdrejtorët dhe shefin e sigurimit në burgje të tjera.

d. Arrestimi ose ndalimi arbitrar

Kushtetuta dhe ligji ndalojnë arrestimin dhe ndalimin arbitrar dhe Qeveria, EULEX-i dhe KFOR-i në përgjithësi i respektuan këto ndalesa.

Roli i policisë dhe i aparatit të sigurisë

Forcat vendëse të sigurisë përfshijnë Policinë e Kosovës dhe Forcën e Sigurisë së Kosovës (FSK). Sipas ligjit, policia funksionon nën autoritetin e Ministrisë së Punëve të Brendshme. EULEX-i funksiononte nën mandatin për t'i monitoruar, mentoruar dhe këshilluar institucionet lokale të gjyqësisë dhe të zbatimit të ligjit. Policia e EULEX-it gjithashtu ka përgjegjësi operative dhe kryen operacione policore sipas mandatit të përcaktuar. EULEX-i posedon autoritet të kufizuar ekzekutiv në fushat që përfshijnë krimin e organizuar, korrupsionin, krimet e luftës, mbrojtjen e dëshmitarëve, shpëlarjen e parave, financimin e terroristëve dhe bashkëpunimin ndërkombëtar policor. FSK-ja është forcë e sigurisë dhe mbrojtjes civile, me armatim të lehtë, e mentoruar nga KFOR-i, që funksionon nën autoritetin civil të Ministrisë së Forcës së Sigurisë të Kosovës.

Njësitë e specializuara policore për hetimin e krimeve të luftës, krimeve financiare dhe krimit të organizuar dhe programi i policisë së EULEX-it për mbrojtjen e dëshmitarëve mbetën të plotësuara me zyrtarë policorë ndërkombëtarë të EULEX-it dhe vepronin në mënyrë të pavarur nga PK-ja. EULEX-i dhe PK-ja në mënyrë të pavarur drejtonin njësitë për zbulim penal dhe krim të organizuar. Zyrtarët policorë, prokurorët dhe gjykatësit ndërkombëtarë të EULEX-it, të stacionuar në tërë vendin, kishin diskrecion të gjerë për të intervenuar në cilëndo çështje të

veçantë penale. Megjithatë, policia vendëse mbajti shumicën e detyrave dhe përgjegjësive policore.

Inspektorati i Policisë (IPK), organ i pavarur nën Ministrinë e Punëve të Brendshme, kryen hetime dhe inspektime në të cilat përfshihet personeli i policisë. Deri në fund të vitit, inspektorati i shqyrtoi 1.078 ankesa. IPK-ja ia përcolli 776 ankesa Njësisë për Standarde Profesionale (NJSP) si shkelje disiplinore dhe i regjistroi 292 ankesa si raste penale. 65 raste penale ishin nën hetim. Autoritetet i dërguan 122 raste në prokurori dhe të tjerat i dërguan me raporte speciale apo i liruan.

IPK-ja i shqyrtoi 10 ankesa për incidente disiplinore të profilit të lartë dhe pesë prej atyre rasteve i la të hapura. Në shtator, IPK-ja e dërgoi një ankesë për masa disiplinore institucionale dhe i mbylli katër raste për shkak të mungesës së provave.

NJSP hetoi kundërvajtjet e vogla të policëve dhe shqiptoi ndëshkime administrative për kundërvajtje. Gjatë këtij viti, njësia hapi 1.235 raste, duke përfshirë rastet e mosbindjes së vogël dhe dëmtimit apo humbjes së pronës policore. Në fund të vitit, 366 raste mbetën në hetim e sipër.

Procedurat e arrestimit dhe trajtimi gjatë ndalimit

Policia në përgjithësi arrestimet i bënte haptas duke përdorur urdhërarrestin e lëshuar nga gjykatësi apo prokurori dhe në bazë të provave të mjaftueshme. Në disa raste, arrestimet kryheshin nga policët e maskuar apo sekretë. Sipas ligjit, arrestimet duhet të bazohen në urdhrat e prokurorit dhe të arrestuarit duhet të sillen para gjykatësit brenda 48 orëve. Shumica e arrestimeve të këtij viti u kryen nga policia. Nuk pati raportime që policia e abuzoi rregullin 48-orësh dhe autoritetet në përgjithësi i akuzonin të arrestuarit brenda gjashtë-tetë orësh apo i lironin. Ligji përcakton që të arrestuarit kanë të drejtë të informohen, në gjuhën që e kuptojnë, për shkakun e arrestimit të tyre; të heshtin dhe të mos u përgjigjen pyetjeve, përveç pyetjeve për identitetin e tyre; për ndihmë falas të përkthyesit; për avokat mbrojtës dhe sigurim të avokatit mbrojtës nëse nuk mund ta paguajnë; dhe për trajtim mjekësor dhe psikiatrik. Policia mund ta mbajë ligjërisht një person përkohësisht nën arrest policor deri në gjashtë orë për ta mbrojtur nga dëmtimi apo rreziku ose nëse personi nuk është bashkëpunues me masa më të vogla. KPT gjeti që disa hetues nuk i njoftonin të ndaluarit për të drejtat e tyre.

OJQ-të raportuan se autoritetet nuk i lejonin të gjithë të ndaluarit të kontaktonin me avokatë me rastin e arrestimit, por vetëm në fillim të marrjes së tyre në pyetje nga polici hetues. Në disa raste, zyrtarët gjoja u mundësuan të ndaluarve qasje në avokat vetëm pas marrjes pyetje. Disa të ndaluar ankoheshin se kontakti i tyre i parë me avokatin ndodhi vetëm pas paraqitjes së tyre të parë në gjykatë edhe pse kishin kërkuar avokat për shkak të detyrës zyrtare menjëherë pas arrestimit.

Ndonëse të ndaluarit kanë të drejtë t'i njoftojnë anëtarët e familjes për ndalimin e tyre, KPT theksoi në raportin e vet të vitit 2010 se respektimi i kësaj të drejte nga autoritetet në përgjithësi

ishte keqësuar që nga vizita e vet në vitin 2007. KPT-ja raportoi se një numër i personave të ndaluar ankoheshin se policia nuk e respektonte kërkesën e tyre për ta njoftuar një anëtar të familjes menjëherë pas arrestimit të tyre dhe se njoftimi bëhej vetëm nga fundi i ndalimit policor. KPT-ja i konfirmoi këto pretendime përmes ekzaminimit të regjistrave dhe të dhënave të ndalimit në disa prej stacioneve policore që i kishte vizituar.

Pas një aktvendimi fillestar, gjykata mund t'i mbajë individët në paraburgim deri në 30 ditë nga dita e arrestimit dhe mund ta vazhdojë ndalimin deri në gjithsej një vit pa aktakuzë. Pas ngritjes së aktakuzës dhe deri në përfundim të procedurës gjyqësore, paraburgimi mund të urdhërohet apo ndërpritet vetëm me vendim të trupit gjykues. Ekziston një sistem funksional mbi dorëzaninë. Ligji lejon arrestin shtëpiak, konfiskimin e dokumenteve të udhëtimit dhe përdorimin e gjerë të dorëzanisë si alternativa ndaj paraburgimit. Të pandehurit gjithashtu mund të ankohen për paraburgimin e tyre.

Në rrethana të jashtëzakonshme, KFOR-i mund t'i arrestojë dhe ndalojë individët pa urdhërarrest. Komandanti i KFOR-it mund t'i ndalojë individët për 72 orë dhe ta vazhdojë atë edhe për 72 orë të tjera. Pas 144 orësh, KFOR-i duhet ta lirojë të ndaluarin. Nuk pati raportime që KFOR-i kishte arrestuar persona pa urdhërarrest gjatë këtij viti.

Paraburgimi: Ndalimet e gjata, para dhe gjatë procedurës gjyqësore, mbetën problem. Ligji lejon që gjykatësi ta shqiptojë masën e paraburgimit nëse ekziston dyshimi i bazuar se personi që ka kryer vepër penale ka të ngjarë t'i shkatërrojë, fshehë apo falsifikojë provat; të ndikojë në dëshmitarë; të ikën; ta përsërisë veprën penale apo të kryejë ndonjë vepër tjetër penale; apo kur masat e tjera të parapara me ligj nuk mjaftojnë për ta siguruar praninë e të pandehurit në procedurën penale. Megjithatë, në praktikë, gjykatësit zakonisht e përdornin paraburgimin pa kërkuar justifikim të mbështetur në prova. Në veçanti, në Gjykatën e Qarkut në Mitrovicë, që është përkohësisht me seli në Vushtrri, autoritetet e kanë vazhduar rregullisht paraburgimin për të pandehur gjatë tërë kohës që gjykata punonte me kapacitet të kufizuar. Në fund të vitit, 655 persona mbetën në paraburgim.

Joefikasiteti i gjyqësorit dhe korrupsioni ishin faktorët që shkaktonin shtyrjen e gjykimeve. Më 13 shtator, Avokati i Popullit pohoi që sistemi gjyqësor është "shkelësi më i madh i të drejtave të njeriut" në vend.

Ndonëse Qeveria bëri përmirësime për t'iu shmangur shqiptimit të ndalimeve të gjata para dhe gjatë procedurave, paraburgimi mbeti problem. Në fillim të vitit, gjykatat i zgjidhën të 741 kërkesat e pazgjidhura që nga viti 2011 lidhur me ndalimin dhe tri ankesa të pranuara gjatë vitit 2010. Gjatë këtij viti, gjyqtarët i shqyrtuan me kohë kërkesat e reja për të shqiptuar ndalime dhe ankesat kundër shqiptimit të ndalimit. Problemet vazhduan në Gjykatën e Qarkut në Mitrovicë dhe autoritetet shpesh ua vazhdonin paraburgimin të pandehurve sepse prokurorët dhe gjykata kishin mundësi të kufizuar për të pasur qasje në dëshmitarë dhe viktima në Kosovën veriore. *Raporti vjetor për gjykata të rregullta* nuk përmban të dhëna për Mitrovicën dhe nuk dihej numri i saktë i të ndaluarve.

Falja: Më 17 shkurt, Presidentja fali 15 individë për nderë të përvjetorit të katërt të pavarësisë së vendit, shumë më pak se viteve të mëparshme. 450 të burgosur i kishin dorëzuar kërkesat për shqyrtim.

e. Mohimi i gjykimit të drejtë publik

Kushtetuta parashikon gjyqësi të pavarur. Megjithatë, gjyqësia nganjëherë ishte e njëanshme, i nënshtrohej ndikimit të jashtëm dhe nuk ofronte gjithmonë proces të drejtë. Pati raportime për korrupsion në gjyqësi dhe sistemi i gjykatave ishte joefikas. U themelua një mekanizëm efikas për procedura disiplinore kundër gjykatësve dhe prokurorëve.

Sistemi i gjykatave përfshinte një gjykatë kushtetuese, një gjykatë supreme, pesë gjykata të qarkut, një gjykatë ekonomike, 25 gjykata komunale, 25 gjykata për kundërvajtje dhe një gjykatë të lartë për kundërvajtje. Përmes EULEX-it, 31 gjykatës ndërkombëtarë dhe 15 prokurorë ndërkombëtarë i mbështetnin gjykatësit dhe prokurorët vendës. Vendi ka një prokurori të shtetit, pesë prokurori të qarkut dhe shtatë prokurori komunale. EULEX-i e ushtroi autoritetin e vet ekzekutiv mbi një prokurori speciale me tetë prokurorë ndërkombëtarë të fokusuar në krime të rënda, duke përfshirë trafikimin e personave, shpëlarjen e parave, krimet e luftës dhe terrorizmin.

Në rastet penale në të cilat gjykatësit ndërkombëtarë të EULEX-it e ushtronin juridiksionin, gjykatësit e EULEX-it shërbenin në kolegje të përziera me gjykatës vendës. Gjykatësit e EULEX-it ishin shumicë në këto kolegje, me një gjykatës të EULEX-it që shërbente si kryetar i kolegjit. Kryetari i Asamblesë së gjykatësve të EULEX-it ka kompetencë të vendosë që kolegji të ketë përbërje të plotë apo shumicë të gjykatësve vendës apo të mos u caktojë faza të posaçme të procedurës gjykatësve të EULEX-it. Për rastet civile në të cilat gjykatësit ndërkombëtarë të EULEX-it e ushtronin juridiksionin, kolegjet gjyqësore përbëheshin prej tre gjykatësve, dy prej tyre ishin gjykatës të EULEX-it. Në kuadër të Këshillit Gjyqësor dhe Prokurorial, Komisioni Disiplinor i heton veprimtaritë e gjykatësve dhe prokurorëve dhe i ndjek penalisht rastet. Deri në fund të vitit, Komisioni Disiplinor paraqiti 45 ankesa kundër prokurorëve, 13 prej tyre u konsideruan sjellje e keqe, 32 të tjera ishin në faza të ndryshme të masave në fund të vitit. Gjatë të njëjtës periudhë, komisioni vendosi për 21 prej 469 ankesave të paraqitura kundër gjykatësve të përfshirë në sjellje të keqe, tetë prej tyre u dërguan për masa më të rënda. Disa prej ankesave nuk u hetuan plotësisht, kështu që nuk janë bërë gjetje përfundimtare.

Prokuroria Speciale e EULEX-it ngriti aktakuzë kundër 10 personave për korrupsion në lidhje me bartjen e pronës që u takonte ndërmarrjeve shoqërore (NSH). Ndër të pandehurit ishin pesë ish-gjykatës të Gjykatës Komunale të Prishtinës, duke përfshirë një ish-kryetar, tre ish-gjykatës të Gjykatës së Qarkut, një avokat dhe një përfaqësues të NSH-ve. Akuzat specifike përfshinin shpërdorimin e pozitës dhe pjesëmarrjen në lëshimin e vendimeve të paligjshme gjyqësore.

Qeveria serbe vazhdoi ta drejtonte një sistem paralel ilegal të gjyqësisë në enklavat serbe në Kosovë dhe në komunat me shumicë serbe.

Procedurat e gjykimit

Gjykimet janë publike dhe të pandehurit gëzojnë prezumimin e pafajësisë, të drejtën për t'u informuar me kohë dhe hollësisht për akuzën, të drejtën për të qenë të pranishëm në gjykimet e veta, të përballen me dëshmitarë, t'i shohin provat dhe të kenë përfaqësim ligjor. Ndonëse autoritetet mund ta sigurojnë përfaqësimin ligjor në shpenzime publike nëse është e nevojshme, kjo procedurë rrallë ndodhte në praktikë. Të pandehurit kanë të drejtë të ankohen. Gjykimet dëgjohen nga kolegjet e përbëra nga gjykatësit profesionalë dhe gjykatësit porotë; nuk ka gjykime me juri.

Komisioni për Ndihmë Juridike, një agjenci e pavarur qeveritare, u ofroi ndihmë juridike falas personave me të ardhura të ulëta. Pjesa më e madhe e ndihmës së ofruar nga Komisioni gjatë këtij viti ishte për çështje civile ose administrative. Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit drejtonte një sektor për avokatë të viktimave, që u ndihmonte viktimave të krimit për të pasur qasje në drejtësi. Ky sektor u ofronte ndihmë juridike falas viktimave të të gjitha krimeve me fokus të veçantë në viktimat e dhunës në familje, trafikim të personave, abuzim të fëmijës dhe dhunim. Ky sektor drejtonte 15 zyra në tërë vendin dhe ofronte ndihmë 24 orë në ditë.

Sektori për integrim gjyqësor, i drejtuar nga Ministria e Drejtësisë, vazhdoi t'i shqyrtonte problemet që ndikonin në pakica. Për atë qëllim, Ministria drejtonte 11 zyra ndërlidhëse të gjykatave për t'u ndihmuar bashkësive pakicë në zonat e Kosovës me shumicë serbe, duke i shoqëruar në gjykata, duke paraqitur dokumente në gjykata në emër të tyre dhe duke u siguruar refugjatëve dhe PZHBV-e informata dhe ndihmë juridike.

EULEX-i i mbikëqyr rastet e krimeve të luftës. EULEX-i mund t'i hetojë dhe gjykojë rastet vetëm apo, kur është e duhur, bashkë me homologët kosovarë. Në dhjetor, një zëdhënës raportoi se EULEX-i ishte duke i hetuar 82 raste të krimeve të mundshme të luftës.

Të burgosurit dhe të arrestuarit politikë

Nuk pati raportime që Qeveria mbante të burgosur apo të arrestuar politikë.

Procedurat dhe mjetet juridike civile

Individët mund të ankohen në gjykata për të kërkuar dëmshpërblim për shkelje të të drejtave të njeriut, apo ndalim të shkeljes së të drejtave të njeriut. Shumë padi të tilla mbetën të pazgjidhura. Individët iu drejtuan Gjykatës Kushtetuese për shqyrtimin e të drejtave të tyre për proces të drejtë. Prej 139 rasteve të paraqitura në Gjykatën Kushtetuese gjatë këtij viti, 73 për qind pohonin shkelje të të drejtave kushtetuese nga gjykatat.

Rikthimi i pronës

Qeveria shënoi përparim në zgjidhjen e rasteve për rikthimin e pronës. Një përzierje konfuze e ligjeve, rregulloreve, udhëzimeve administrative dhe praktikave gjyqësore, si dhe rizënia ilegale e pronave dhe ankesat e shumta për të njëjtën pronë e ndërlikonin zgjidhjen e rasteve të të drejtave pronësore.

Agjencia Kosovare e Pronës (AKP) i zgjidh kërkesat për pronën rezidenciale, komerciale dhe bujqësore që dalin nga konflikti i Kosovës. Komisioni për kërkesa pronësore i Kosovës raportoi se deri në dhjetor kishte shqiptuar vendime për 35.109 kërkesa prej 42.360 kërkesave të regjistruara dhe i kishte njoftuar 30.408 parashtrues të kërkesave për konkluzione e veta. Sekretaria Ekzekutive e AKP-së pranoi 495 ankesa kundër vendimeve të tyre dhe i dërgoi 380 ankesa në Gjykatën Supreme për masa të mëtejme.

AKP përjetoi vështirësi në zbatimin e vendimeve të veta gjatë dëbimit të banorëve të paligjshëm, posaçërisht në Mitrovicën veriore ku serbët e Kosovës dhe shqiptarët e Kosovës shpesh refuzonin t'i lironin pronat që ligjërisht u takonin anëtarëve të grupit tjetër. Agjencia më shpesh i dërgonte rastet e "rizënies serike" (në të cilën banorët e dëbuar ktheheshin për të jetuar në pronat që ligjërisht nuk ishin të tyre) në prokurori dhe polici për masa të mëtejme.

AKP kishte mungesë të fundeve për kompensim për t'i zgjidhur 143 rastet e vendosura nga Drejtoria për Çështje Banesore dhe Pronësore në favor të parashtruesve të kërkesave që i kishin humbur pronat e tyre ë fillim të viteve 1990 për shkak të praktikave diskriminuese banesore që zbatoheshin nganjëherë në atë kohë.

Numri i pazgjidhur i kërkesave pronësore në gjykata komunale mbeti i lartë, rreth 20.000 në fund të vitit, që ishin pothuaj vetëm kërkesa financiare të serbëve të Kosovës për dëme të lidhura me luftën. Kosova nuk pati sistem efektiv dhe efikas për t'u mundësuar rreth 200.000 serbëve të zhvendosur në Serbi të paraqitnin kërkesa pronësore dhe kërkesa të tjera nga Serbia.

f. Ndërhyrja arbitrare në intimitet, familje, shtëpi apo korrespondencë

Kushtetuta dhe ligji ndalojnë veprime të tilla dhe Qeveria, EULEX-i dhe KFOR-i në përgjithësi i respektuan këto ndalesa në praktikë. Forcat e KFOR-it mbajtën mundësinë për t'i ndihmuar policisë vendëse dhe policisë së EULEX-it në kryerjen e kontrollimeve për të dyshuar të rrezikut të lartë dhe në mënyrë të pavarur kontrollonin pronën private për armë, pa urdhër të gjykatës, duke u bazuar në autoritetin paqeruajtës të Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së. KFOR-i nuk kreu asnjë kontrollim të tillë gjatë këtij viti.

Seksioni 2. Respektimi i lirive civile, duke përfshirë:

a. Lirinë e fjalës dhe të shtypit

Kushtetuta dhe ligji parashikojnë lirinë e fjalës dhe të shtypit dhe Qeveria në përgjithësi i respektoi këto të drejta në praktikë. Megjithatë, pati raportime që përfaqësuesit e medieve ishin

kërcënuar nga zyrtarët publikë, politikanët dhe bizneset. Mediet gjithashtu hasën në vështirësi me rastin e marrjes së informatave nga Qeveria dhe institucionet publike; këtë e përkeqësoi edhe më tej dështimi i Qeverisë për ta emëruar një zëdhënës.

Liria e shtypit: Mediet e pavarura ishin aktive dhe shprehën një gamë të gjerë të pikëpamjeve, në përgjithësi pa kufizim; megjithatë, pati raportime për presion verbal nga zyrtarët qeveritarë dhe bizneset e lidhura me Qeverinë për të mos publikuar storje apo materiale të caktuara. Sipas Asociacionit të Gazetarëve Profesionistë të Kosovës (AGPK), vështirësitë financiare të medieve bënë që pavarësia redaksionale dhe profesionalizmi gazetaresk i medieve të shkruara dhe elektronike t'i nënshtrohej ndikimit dhe presionit të jashtëm.

Disa medie të shkruara ishin financiarisht të pavarura dhe ishin në gjendje të zhvillonin politika redaksionale të pavarura nga interesat politike apo të biznesit. Mediet e tjera me më pak resurse nganjëherë pranonin ndihmë financiare nga një sërë burimesh në shkëmbim për raportim pozitiv apo për mospublikim të storjeve negative që do të mund t'i dëmtonin interesat e financuesve.

Mediet transmetuese kishin qasje në një bazë më të madhe të të hyrave sesa mediet e shkruara. Publiku i perceptonte mediet transmetuese si më të pavarura, por stacionet e vogla raportonin se vazhdimisht ishin në rrezik të mbylljes dhe gjithnjë e më shumë vareshin nga burimet e jashtme të financimit për ekzistimin e tyre.

Buxheti i transmetuesit publik, Radiotelevizionit të Kosovës (RTK), kontrollohet nga Kuvendi. Ligji parashikon rregullimin e përmbajtjes së programit të RTK-së dhe kërkon që së paku 15 për qind e kohës së programit të RTK-së, duke përfshirë kohën qendrore, t'u kushtohet bashkësive pakicë në gjuhën e tyre përkatëse në baza proporcionale.

Më 29 mars, Kuvendi miratoi një ligj të ri për RTK-në, i cili kërkonte themelimin e një kanali të dytë televiziv në gjuhën serbe. Bordi i RTK2 e emëroi drejtorin e përkohshëm më 5 shtator, por stacioni nuk filloi punën as në fund të vitit.

Më 14 dhjetor, dy grupe të protestuesve e sulmuan ndodhinë me rastin e publikimit dhe promovimit të numrit më të ri të revistës *Kosova 2.0* për çështje të seksit, e cila mbështeste diskutime të hapura dhe të sinqerta publike për edukatën seksuale, shëndetin dhe të drejtat e LHBT-ve. Një grup prej 15 – 20 personash depërtoi kordonin e policisë të vendosur në hyrje, shkatërroi pronën dhe sulmoi stafin e revistës. Policia e arrestoi një person për dëme materiale dhe e liroi po atë natë. Më vonë atë natë, 100 – 300 persona u paraqitën në sallë duke bërtitur parulla fetare dhe fjalim urrejtës. Organizatorët mbajtën një ngjarje të modifikuar pas protestës së parë, por më vonë i pezulluan aktivitetet e tjera për shkak të frikës për sigurinë e mysafirëve të tyre. Policia formoi një task forcë për t'i hetuar ngjarjet, të cilat vazhduan në fund të vitit.

Dhuna dhe ngacmimi: Gjatë këtij viti, AGPK raportoi për 24 raste të abuzimit të lirisë së shtypit nga zyrtarë qeveritarë, grupe të interesit afarist apo pronarë të medieve, duke përfshirë sulmet fizike, kërcënimet verbale ndaj gazetarëve, presionin ndaj medieve për të mos publikuar

materiale dhe artikuj dhe pengimin e punës së gazetarëve. Sipas AGPK-së, shumë gazetarë ankoheshin që redaktorët nuk i lejonin të publikonin apo transmetonin storje kritike për Qeverinë apo zyrtarë të caktuar për shkak të lidhjeve të redaktorëve apo të medieve me zyrtarë të lartë qeveritarë. Në disa raste, gazetarët raportonin që redaktorët i kërcënonin se do t'i largonin nga puna nëse vazhdonin të publikonin storje kritike për Qeverinë. Disa gazetarë u ankuan që redaktorët i ndaluan të publikonin storje për korrupsion të nivelit të lartë në Qeveri.

Më 14 janar, një polic fizikisht e sulmoi dhe rrahu fotoreporterin Vedat Xhymshiti gjersa xhironte ngjarjet gjatë një konflikti në një vendkalim kufitar mes Kosovës dhe Serbisë. Më 14 maj, Xhymshiti ushtroi padi kundër Qeverisë dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme. Xhymshiti më vonë u largua nga vendi gjoja pasi ishte kërcënuar. Më 10 qershor, autoritetet komunale të Gjilanit ngrenë padi kundër policit Faruk Ibrahimi për abuzim të gazetarëve. Në fund të vitit, prokuroria nuk kishte përparuar në këtë rast.

Më 27 shtator, AGPK-ja lëshoi një deklaratë me të cilën i dënonte kërcënimet e shpeshta të drejtuara kundër gazetarit Adem Meta dhe familjes së tij nga kryetari i komunës së Skenderajt, Sami Lushtaku, dhe nënkryetari i komunës. Zyrtarët komunalë gjoja kundërshtuan reportazhin e Metës dhe analizimin e politikave dhe aktiviteteve të tyre. Thuhet që bashkëpunëtorët fizikisht e ndalën kryetarin e komunës më 9 mars kur u përpoq ta sulmonte Metën gjatë një debati publik dhe persona të panjohur u kërcënuan që gazetari dhe familja e tij do të "vuanin pasoja". Meta ushtroi padi kundër Lushtakut dhe autoritetet filluan hetimin.

Organizata e Medias për Evropën Juglindore lëshoi një deklaratë me të cilën e dënonte presionin që ushtrohej nga kryetari i komunës së Prizrenit, Ramadan Muja, kundër gazetarëve të programit televiziv "Drejtësia në Kosovë" të fokusuar në korrupsion. Thuhej që kryetari i komunës i kërcënoi gazetarët gjersa shefi i tij i protokollit u përpoq ta largonte ekipin nga një vendtakim publik kur u përpoq ta intervistonte atë për shpërdorim të fondeve komunale.

Censurimi dhe kufizimi i përmbajtjes: Ndonëse nuk kishte raporte për censurim të drejtpërdrejtë të medieve të shkruara apo elektronike, gazetarët raportonin që presioni nga politikanët dhe krimi i organizuar shpesh rezultonte në vetëcensurim. Disa gazetarë përmbaheshin nga raportimi hetues kritik për shkak të frikës për sigurinë e tyre personale apo vendin e tyre të punës. Gazetarëve nganjëherë u ofroheshin përfitime financiare në shkëmbim për raportim pozitiv apo heqje dorë nga hetimi dhe zyrtarët qeveritarë dhe kriminelët e dyshuar gojarisht i kërcënonin gazetarët për raportimin që konsiderohej negativ. Sipas disa redaktorëve, agjencitë qeveritare dhe korporatat i tërhiqnin reklamat nga gazetat që publikonin material kritik për to.

Liria e internetit

Qeveria nuk e kufizoi qasjen në internet dhe nuk pati raportime që Qeveria i vëzhgonte e-mailat apo bisedat në internet. Individët dhe grupet mund t'i shprehnin mendimet përmes internetit, duke përfshirë e-mailat.

Pothuaj të gjitha zonat urbane kishin qasje të plotë në internet; zonat rurale kishin më pak mbulesë. Autoriteti Rregullativ i Telekomunikacionit raportoi në qershor se 45 për qind e shtëpive kishin lidhje interneti. Një sondazh i publikuar në maj nga Shoqata për Teknologji të Informimit dhe Komunikimit të Kosovës vuri në pah se 46 për qind e popullatës e përdorte internetin herë pas here dhe 80 për qind përditë.

Liria akademike dhe ngjarjet kulturore

Qeveria nuk e kufizonte lirinë akademike apo ngjarjet kulturore.

b. Liria e tubimit paqësor dhe asociimit

Liria e tubimit

Kushtetuta dhe ligji parashikojnë lirinë e tubimit dhe Qeveria, EULEX-i dhe KFOR-i në përgjithësi e respektuan këtë të drejtë në praktikë.

Ligji për tubime publike kërkon që organizatorët ta njoftojnë policinë për protesta 72 orë para ndodhisë. Policia duhet t'i njoftojë organizatorët brenda 48 orëve nëse protesta do të lejohet.

Më 22 tetor, një protestë e paparalajmëruar dhe e palejuar, e organizuar nga "Vetëvendosje" (VV) kundër dialogut të Qeverisë me Serbinë, u bë e dhunshme pasi rreth 100 protestues që përpiqeshin t'i pengonin zyrtarët qeveritarë për të hyrë në ndërtesë filluan të gjuanin sende në drejtim të policisë. Policia u përgjigj me gaz lotsjellës për ta shpërndarë turmën. Protesta dhe përleshja vazhduan gjatë tërë ditës në qendër të Prishtinës. Policia raportoi se 12 protestues dhe 18 policë pësuan lëndime. Policia i arrestoi 63 persona dhe i lëshoi brenda 48 orëve. VV kërkoi hetim duke pohuar që PK përdori dhunë të tepruar gjatë protestës dhe më vonë kundër të ndaluarve. Më 25 tetor, zyrtarët qeveritarë miratuan hetimet e Inspektoratit Policor dhe të EULEX-it në stacione policore, por besuan që policia veproi në mënyrë profesionale. Pas hetimeve të IPK-së, pesë raste të zyrtarëve policorë u dërguan në NJSP për shkelje disiplinore.

Liria e asociimit

Kushtetuta dhe ligji parashikojnë lirinë e asociimit dhe Qeveria në përgjithësi e respektoi këtë të drejtë në praktikë.

c. Liria e fesë

Shih *Raportin ndërkombëtar mbi lirinë e fesë* të Departamentit të Shtetit në: www.state.gov/g/drl/irf/rpt.

d. Liria e lëvizjes, personat e zhvendosur brenda vendit, mbrojtja e refugjatëve dhe personat pa shtetësi

Kushtetuta dhe ligji parashikojnë lirinë e lëvizjes brenda vendit, udhëtimin jashtë vendit, emigrimin dhe riatdhesimin dhe Qeveria e EULEX-i në përgjithësi i respektuan këto të drejta; megjithatë, tensionet ndëretnike, barrikadat e vendosura nga ekstremistët serbë dhe brengat e vërteta e të perceptuara të sigurisë e kufizonin lirinë e lëvizjes në praktikë. Brengat e sigurisë gjithashtu penguan një numër të serbëve të Kosovës që të ktheheshin në Kosovë.

Qeveria bashkëpunoi me Komisariatin e Lartë të Kombeve të Bashkuara për Refugjatë (UNHCR) dhe organizata të tjera humanitare për t'u ofruar mbrojtje dhe ndihmë personave të zhvendosur brenda vendit, refugjatëve, refugjatëve që ktheheshin, azilkërkuesve, personave pa shtetësi dhe grupeve të tjera të cenuara.

Policia e vlerësoi situatën e sigurisë si stabile, por të brishtë. Anëtarët e të gjitha bashkësive etnike vazhduan të qëndronin kryesisht brenda apo të udhëtonin ndërmjet zonave në të cilat grupi i tyre përbënte shumicën.

Lëvizjet brenda vendit: Ekstremistët dhe strukturat paralele serbe vazhduan të vendosnin barrikada në Kosovën veriore si reagim ndaj përpjekjes së përbashkët EULEX-KFOR-Qeveri e Kosovës për t'i zbatuar marrëveshjet e arritura në dialogun Kosovë-Serbi të ndihmuar nga BE-ja. Barrikadat e kufizuan lëvizjen dhe në disa raste krejtësisht e ndërprenë qasjen në zona. Përveç kësaj, rreziqet e perceptuara dhe incidentet sporadike të dhunës dhe kërcënimit vazhduan ta kufizonin lirinë e lëvizjes për shqiptarët e Kosovës në veri dhe për serbët e Kosovës në pjesët e tjera të vendit. Ekstremistët serbë gjithashtu vendosën barrikada në dhjetor kur autoritetet filluan zbatimin e Marrëveshjes për Menaxhim të Integruar të Kufirit, të arritur në Bruksel nga autoritetet e Kosovës dhe të Serbisë. Barrikadat herë pas here e vononin komunikacionin për periudha të shkurta kohore.

Udhëtimi jashtë vendit: Grupe të pakicës serbe të Kosovës në rajonin verior pohuan që Qeveria ua kufizoi lirinë e lëvizjes vitin e kaluar kur filloi zbatimin e marrëveshjes për targa të arritur vitin paraprak në dialogun teknik ndërmjet Qeverisë së Kosovës dhe të Serbisë. Qeveria ofroi kohë shtesë, jashtë kornizës së vet të rregullt, në mënyrë që serbët e Kosovës t'i merrnin patentë shoferët dhe targat dhe e vazhdoi afatin disa herë para zbatimit të rregullave.

Personat e zhvendosur brenda vendit (PZHBV)

Sipas UNHCR-së, në dhjetor vendi kishte 17.738 persona të regjistruar të zhvendosur brenda vendit nga konflikti i vitit 1998-1999 dhe dhuna e mëvonshme, duke përfshirë 9.615 serbë të Kosovës, 7.236 shqiptarë të Kosovës, 380 romë të Kosovës, 242 ashkalinj të Kosovës, 231 egjiptianë të Kosovës, tetë boshnjakë të Kosovës, 15 goranë të Kosovës dhe 11 anëtarë të përkatësive të tjera etnike. 372 familje, me gjithsej 977 persona, ngelën në 38 strehimoret e vendit. Sipas Qendrës për monitorim të zhvendosjes brenda vendit, një numër i madh i romëve, ashkalinjve dhe egjiptianëve mbetën të paregjistruar dhe të panumëruar nga autoritetet. Shumë

romë, ashkalinj dhe egjiptianë të zhvendosur e të paregjistruar jetonin në vendbanime joformale të cilave u mungonin rryma dhe shërbimet e tjera themelore.

Rreth 200.000 persona të zhvendosur nga Kosova mbetën në Serbi. Rreth 1.100 persona ktheheshin në vend çdo vit dhe kërkonin mbështetje substanciale për t'i përmbushur nevojat e veta. Romët ballafaqoheshin me një shkallë të lartë të diskriminimit në Kosovë.

Gjatë këtij viti, Ministria për Komunitete dhe Kthime ndau 6,5 milionë euro ($8,6 milionë) për kthim dhe ndihmë për familje. Donatorët ndërkombëtarë gjithashtu u siguruan mjete financiare drejtpërsëdrejti partnerëve zbatues të projekteve për kthime në koordinim me Ministrinë për Komunitete dhe Kthime. Autoritetet i shpenzuan këto fonde në rindërtimin e shtëpive, për ndihmë juridike, ushqim dhe gjëra joushqimore, në grante për gjenerimin e të ardhurave dhe mbështetje të infrastrukturës themelore, si të rrugëve dhe sistemeve të ujit. Mungesa e shtëpive dhe kushtet e vështira ekonomike mbetën pengesat kryesore për kthim. Thuhej që shumë familje ngurronin të ktheheshin në shtëpi për shkak të brengave të sigurisë, shërbimeve të dobëta lokale dhe vështirësive për riposedimin dhe rindërtimin e pronave të tyre. Në nevoja të tjera përfshiheshin shkollimi joadekuat në gjuhën serbe dhe shërbimet shëndetësore.

Mbrojtja e refugjatëve

E drejta për azil: Ligji parashikon dhënien e statusit të azilantit apo refugjatit dhe Qeveria ka themeluar një sistem për të ofruar mbrojtje për refugjatë. Gjatë këtij viti, UNHCR-ja e ndihmoi Departamentin për Shtetësi, Azil dhe Migrim në ndërtimin e kapacitetit të vet për të gjykuar kërkesa dhe ofroi trajnim për gjyqësorin në mbrojtjen e refugjatëve ndërkombëtarë.

UNHCR-ja i regjistroi 4.327 persona që u kthyen në Kosovë, kryesisht nga vendet e Evropës Perëndimore, deri në fund të dhjetorit. Në këtë numër përfshihen 799 anëtarë të bashkësive pakicë që me dhunë u kthyen në Kosovë; 65 goranë, 44 boshnjakë, 41 serbë të Kosovës, 462 romë, 163 ashkalinj, 10 turq, tre egjiptianë dhe 11 shqiptarë të kthyer në zonat në vend ku llogariteshin pakicë.

Zgjidhjet e qëndrueshme: Ministria e Punëve të Brendshme përuroi një qendër të re azili në Prishtinë në muajin mars. Qendra e re, e ndërtuar me fonde të BE-së, ka kapacitet për strehimin e 50 personave. Sipas UNHCR-së, 45 azilkërkues paraqitën kërkesë për mbrojtje ndërkombëtare në vend gjatë këtij viti. Departamentit për Shtetësi, Azil dhe Migrim dhe qendra për azil i akomoduan të gjithë azilkërkuesit. Në fund të vitit, nëntë azilkërkues mbetën në vend. Asnjë azilkërkuesi nuk i është njohur statusi i refugjatit që kur Qeveria mori përgjegjësinë për përcaktimin e statusit të refugjatit në vitin 2008.

Personat pa shtetësi

Shifrat zyrtare për personat pa shtetësi nuk ishin në dispozicion. Megjithatë, UNHCR-ja u ndihmoi 2.499 personave për të marrë dokumente personale dhe për t'i zgjidhur çështjet e

statusit civil për ta parandaluar dhe zvogëluar numrin e personave pa shtetësi. Shumica e personave të ndihmuar ishin të bashkësive rome, ashkalike dhe egjiptiane që jetonin në Kosovë. Fëmijët e fitojnë shtetësinë nga prindërit e vet apo për shkak të lindjes në vend.

Gjatë këtij viti Qeveria i miratoi nëntë procedura për zbatimin e seksioneve të Ligjit për gjendjen civile. Udhëzimi Administrativ për regjistrimet e mëvonshme përfshin kritere për regjistrimet e mëvonshme për personat që nuk janë në gjendje të ofrojnë dëshmi (gjurmët e gishtërinjve për personat mbi moshën 16 vjeçare, fotografitë, nënshkrimin dhe deklaratat e dy dëshmitarëve). Kur regjistrimi i mëvonshëm i propozuar dëshmoi të ishte pengesë e madhe për parashtruesit e kërkesës, zyrtarët e Ministrisë së Punëve të Brendshme hoqën pagesën e taksave administrative për anëtarët e cenueshëm të komunitetit për një vit.

Gjatë këtij viti Qeveria e ndryshoi kornizën kombëtare ligjore lidhur me personat pa shtetësi për të ofruar mënyra shtesë për natyralizim. Në veçanti, ligji i ri e zgjeron parimin *jus soli*, i cili më parë ua kufizonte shtetësinë thjeshtërve, për t'ua lejuar të drejtën e fitimit të shtetësisë fëmijëve të lindur në vend nga prindërit që edhe vetë janë pa shtetësi.

Seksioni 3. Respektimi i të drejtave politike: E drejta e qytetarëve për ta ndërruar Qeverinë e tyre

Kushtetuta dhe ligji parashikojnë të drejtën e qytetarëve për ta ndërruar qeverinë e tyre në mënyrë paqësore dhe qytetarët e ushtruan këtë të drejtë në praktikë përmes zgjedhjeve periodike, të lira e të drejta, në bazë të votimit të përgjithshëm.

Qeveria serbe vazhdoi të udhëhiqte struktura paralele ilegale qeveritare në enklavat serbe në Kosovë.

Zgjedhjet dhe pjesëmarrja politike

Zgjedhjet e fundit: Në dhjetor të vitit 2010 dhe në janar të vitit 2011, vendi mbajti zgjedhjet për Kuvend të përcjella me parregullsi, manipulime zgjedhore dhe dështime teknike. Vëzhguesit vendës dhe ndërkombëtarë theksuan që zgjedhjet përmbushën shumë standarde ndërkombëtare, por vunë në pah parregullsi të mëdha dhe manipulime zgjedhore në disa zona, duke përfshirë shkeljen e procedurave zgjedhore, falsifikimin e nënshkrimeve në listën e votuesve dhe parregullsitë në numërim. Ata raportuan për incidente të votimit familjar (kreu i familjes votonte në emër të femrave të familjes) në tërë vendin. Vëzhguesit gjithashtu cituan shembuj të presionit dhe kërcënimit ndaj vëzhguesve vendorë.

Në shkurt të vitit 2011, pas seancës konstituive, Kuvendi miratoi Qeverinë e re të koalicionit, të drejtuar nga Partia Demokratike e Kosovës e Kryeministrit Hashim Thaçi dhe Behgjet Pacollin e zgjodhi President.

Një gjykatë konstatoi që zgjedhja e Presidentit Pacolli nga Kuvendi shkeli Kushtetutën sepse nuk kishte kuorum të vlefshëm për ta mbajtur votimin dhe vetëm një kandidat garonte për zgjedhje. Gjykata e anuloi votimin e Kuvendit dhe menjëherë ia ndërpreu mandatin Pacollit. Më pas udhëheqësit politikë u pajtuan për një kandidat konsensual dhe, në prill të vitit 2011, Kuvendi e zgjodhi Atifete Jahjagën President. Palët e bazuan marrëveshjen politike të vitit 2011 në bërjen e reformave kushtetuese për të ofruar zgjedhje të drejtpërdrejtë të presidentëve të ardhshëm nga elektorati dhe për reforma kuptimplote zgjedhore.

Më 6 korrik, Gjykata Kushtetuese vendosi që marrëveshja politike e vitit 2011 që shpuri në zgjedhjen e Atifete Jahjagës për President nuk mund të përdorej për ta detyruar atë që të jepte dorëheqje para përfundimit të mandatit të plotë. Grupet punuese për reforma u takuan herë pas here gjatë vitit dhe procesi i reformimit vazhdoi në fund të vitit.

Partitë politike: Partitë politike vepronin pa kufizim apo ndërhyrje të jashtme, por lidhja partiake luante rol të rëndësishëm në qasje në shërbime qeveritare e sociale dhe në mundësi për punësim. Besnikëritë klanore gjithashtu luanin rol të rëndësishëm, ndonëse jozyrtar, në organizatat politike.

Pjesëmarrja e femrave dhe pakicave: Ligji për zgjedhje kërkon që femrat të përbëjnë 30 për qind të parlamentarëve. 40 femra ishin në Kuvendin 120-anëtarësh. Asnjë femër nuk ishte zgjedhur kryetar komune.

25 anëtarë të pakicave etnike ishin në Kuvend, duke përfshirë 13 serbë të Kosovës dhe 12 anëtarë të grupeve të tjera, përfshirë turqit, boshnjakët, goranët, romët, ashkalinjtë dhe egjiptianët. Kushtetuta garanton 10 vende në Kuvend për serbët e Kosovës dhe 10 vende për anëtarët e grupeve të tjera etnike.

Seksioni 4. Korrupsioni dhe mungesa e transparencës në Qeveri

Ligji parashikon dënime penale për korrupsion zyrtar; megjithatë, Qeveria nuk e zbatoi ligjin në mënyrë efikase dhe thuhej që zyrtarët përfshiheshin në praktika korruptuese. Pati raportime për korrupsion në Qeveri gjatë këtij viti.

Organizatat ndërkombëtare dhe OJQ-të vazhduan të raportonin se korrupsioni ishte problem serioz. Mungesa e mbikëqyrjes efektive gjyqësore dhe dobësia e përgjithshme në sundimin e ligjit i kontribuuan korrupsionit në Qeveri. Pati perceptim të gjerë publik për korrupsion të përhapur në Qeveri.

Grupe të shumta të Qeverisë dhe të shoqërisë civile dhe organizata ndërkombëtare në mënyrë aktive mbështetën dhe zbatuan programe kundër korrupsionit. Programi i OKB-së për Zhvillim (UNDP) e sponsorizoi dhe zhvilloi ueb-platformën e konceptuar vendëse “www.kallxo.com,” e cila mundësonte raportimin dhe regjistrimin e ankesave për korrupsion në tërë vendin përmes internetit, medieve sociale dhe SMS-ve. Në katër muajt e parë të punës së saj, qytetarët e

përdorën këtë platformë për t'i raportuar mbi 300 raste të supozuara të korrupsionit. Instituti Demokratik i Kosovës themeloi një linjë të drejtpërdrejtë kundër korrupsionit më 20 shtator.

Më 16 nëntor, prokurorët ngritën aktakuzë kundër deputetit të PDK-së, Fatmir Limaj, dhe gjashtë të dyshuarve të tjerë për manipulim me procedura të tenderimit, dhënie dhe marrje të ryshfetit dhe pengim të provave për fitime personale dhe/ose materiale në lidhje me tre tenderë në Ministrinë e Transportit dhe Postë Telekomunikacionit. Dëmet gjoja arritën shumën e përgjithshme rreth dy milionë euro (($2,6 milionë). Më 11 shtator, prokurorët e morën në pyetje Limajn për shumën prej 800.000 eurove ($1,06 milionë) që i ishte paguar avokatit të tij mbrojtës gjatë gjykimit për krime lufte, që sugjeron mundësinë se Limaj kishte marrë fonde nga operacionet për shpëlarjen e parave.

Në maj, autoritetet i arrestuan 10 izraelitë, duke përfshirë Moshe Harelin, pasi prokurori i EULEX-it Jonathan Ratel tha se Moshe Harel "dhe disa të dyshuar të tjerë" ishin arrestuar më parë në Izrael "në lidhje me një hetim [atje]". Prokurori i EULEX-it tha se kishte "bashkëpunim të ngushtë me autoritetet në Izrael" lidhur me urdhërarrestin ndërkombëtar të lëshuar nga Interpoli për Moshe Harelin sipas kërkesës së Prokurorisë Speciale të Kosovës. Zyrtarja për informim e EULEX-it, Bardha Azari, raportoi se dyshohej që ai ishte i përfshirë në një rrjet ndërkombëtar të trafikimit të organeve që ka lidhje me klinikën e mbyllur vendëse Medicus, të udhëhequr nga turku Yusuf Sonmez, deri në vitin 2008; Sonmez mbeti në liri. Pesë qytetarë vendës të akuzuar në të njëjtin hetim ngelën nën aktakuzë për trafikim të organeve të njeriut, krim të organizuar, veprimtari të paligjshme mjekësore dhe shpërdorim të autoritetit zyrtar në vitin 2008. Gjykimi i tyre, që filloi në vitin 2011 në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë, vazhdoi në fund të vitit. Të shtatë të pandehurit në këtë rast, duke përfshirë ish-zyrtarin e Ministrisë së Shëndetësisë, Ilir Rrecaj, u deklaruan të pafajshëm. Rasti Medicus ishte i ndarë dhe nuk kishte lidhje me pretendimet e përfshira në Raportin e vitit 2010 të Këshillit të Evropës për Trajtim Çnjerëzor të Njerëzve dhe Trafikim të Paligjshëm të Organeve Njerëzore në Kosovë, të cilin Task Forca Speciale Hetuese e EULEX-it vazhdoi ta hetonte në fund të vitit.

Korrupsioni dhe ndikimi i Qeverisë mbetën problem ndër forcat e sigurisë.

Më 12 maj, Gjykata e Qarkut në Prishtinë i liroi drejtorin e Doganës, Naim Huruglica, dhe këshilltarin juridik të Doganës, Lulzim Rafuna, nga akuzat për shpërdorim të pozitës zyrtare në skemën e pretenduar për t'ia privuar Qeverisë të ardhurat tatimore nga cigaret. Më 3 prill, policia e arrestoi shefin e Task Forcës kundër Korrupsionit, Nazmi Mustafi, Xhelal Zherkën dhe Mirela Ndocin për vepra të lidhura me korrupsionin. Prokurorët pohuan që Mustafi kishte marrë ryshfet si shkëmbim për hedhjen e akuzave për korrupsion kundër individëve të tjerë. Më 20 shtator, një gjykatës i konfirmoi akuzat e prokurorit. Autoritetet e akuzuan Mustafin për shpërdorim të detyrës dhe posedim të paautorizuar të armëve. Të tjerët akuzoheshin për tregti në ndikim, nxitje ose ndihmë për ta shpërdorur pozitën ose autoritetin zyrtar, marrje të dokumenteve zyrtare dhe mashtrim të blerësve.

Më 12 shtator, autoritetet e arrestuan zyrtarin e lartë të LDK-së, Sami Hamiti, dhe dy afaristë të tjerë, Agim Ademin dhe Muharrem Ramën, nën dyshimin për korrupsion dhe zhvatje. Prokurorët dyshuan që këta të tre bashkëpunuan për t'i ndryshuar në mënyrë të paligjshme rregulloret e planifikimit urban në Prishtinë.

Agjencia kundër Korrupsionit dhe Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP) janë dy agjencitë kryesore përgjegjëse për luftimin e korrupsionit në Qeveri. Deri në dhjetor, Agjencia kundër Korrupsionit kishte pranuar 150 raporte për korrupsion, përveç 80 rasteve të bartura nga viti 2011; 40 raste ishin referuar për ndjekje penale, 10 i ishin kaluar PK-së, rreth 100 u mbyllën për shkak të mungesës së provave dhe rreth 80 raste mbetën në hetim e sipër.

ZAP-i kontrolloi menaxhimin dhe përgjegjësinë fiskale në Qeverinë qendrore, në organet komunale dhe në ndërmarrjet publike. Gjatë këtij viti, ZAP auditoi shumicën e ministrive, Zyrën e Presidentit dhe Kuvendin.

Ligji parashikon qasje publike në informata qeveritare dhe gjoba për institucionet dhe zyrtarët që nuk ofrojnë qasje në informata siç kërkohet me ligj.

Seksioni 5. Qëndrimi qeveritar në lidhje me hetimin ndërkombëtar dhe joqeveritar të shkeljeve të supozuara të të drejtave të njeriut

Një numër i madh i grupeve vendëse dhe ndërkombëtare për të drejtat e njeriut në përgjithësi punuan pa kufizim, duke hetuar dhe botuar konkluzionet e veta për rastet e të drejtave të njeriut. Qeveria nganjëherë bashkëpunonte dhe u përgjigjej pikëpamjeve të tyre. Qeveria nganjëherë takohej me monitorues të OJQ-ve vendëse, u përgjigjej pyetjeve të tyre, apo ndërmerrte masa si përgjigje ndaj raporteve apo rekomandimeve të tyre.

Organet qeveritare për të drejtat e njeriut: Zyra e Avokatit të Popullit ka kompetencë për t'i hetuar pohimet për shkelje të të drejtave të njeriut dhe abuzim të autoritetit qeveritar. Vëzhgues të të drejtave të njeriut e konsideronin zyrën joefikase, por më aktive se viteve të kaluara. Avokati i Popullit vazhdimisht i vizitonte të gjitha komunat në vend dhe lëshonte deklarata publike pas ngjarjeve të rëndësishme. *Studimi i fizibilitetit i vitit 2012 për Kosovën* i Komisionit Evropian i rekomandoi Qeverisë që ta forconte kapacitetin dhe pavarësinë e institucionit duke siguruar që kishte burime adekuate dhe që punonjësit e saj ishin të mbuluar sipas ligjeve me të cilat qeveriseshin pagat e shërbimit civil. Në dhjetor, Qeveria miratoi një buxhet ku përfshihej shuma e plotë e mjeteve financiare të kërkuara nga Avokati i Popullit.

Seksioni 6. Diskriminimi, abuzimet shoqërore dhe trafikimi i personave

Ligji posaçërisht ndalon diskriminimin në bazë të racës, gjinisë, prejardhjes etnike, aftësisë së kufizuar, statutit shoqëror apo gjuhës. Qeveria nuk i zbatonte në mënyrë efikase këto ndalesa.

Femrat

Dhunimi dhe dhuna në familje: Ligji e konsideron dhunimin vepër penale, por nuk e trajton dhunimin bashkëshortor në mënyrë të posaçme. Sipas Kodit Penal, dhunimi dënohet prej 2 – 10 vjet burg; dhunimi i të miturës (marrëdhënia seksuale me një fëmijë nën moshën 16-vjeçare) dënohet prej 5 – 20 vjet burg. Dhunimi që përfshin vrasjen dënohet prej 10 – 40 vjet burg. Vëzhguesit besuan që nuk u raportua në masë të madhe për dhunimin për shkak të turpit kulturor që u bashkëngjitej viktimave dhe familjeve të tyre.

Dhuna në familje ndaj femrave, duke përfshirë abuzimin bashkëshortor, mbeti problem serioz dhe i vazhdueshëm. Ligji ndalon dhunën në familje dhe parasheh dënime me burg prej 6 muaj deri në 5 vjet. Ligji e trajton dhunën në familje si çështje civile, nëse viktima nuk ka pësuar lëndime trupore. Dështimi për ta respektuar aktgjykimin e një gjykate civile që ka të bëjë me dhunën në familje është vepër penale dhe mund të ndiqet penalisht. Thuhej që policia reagoi me vend ndaj supozimeve për dhunim dhe dhunë në familje.

Kur viktimat ngrinin padi, njësitë policore për dhunë në familje kryenin hetime dhe ua kalonin rastet prokurorëve. Prokuroria Speciale ia atribuonte shkallën e ulët të ndjekjes penale besnikërive familjare, varfërisë dhe numrit të rasteve të grumbulluara në gjykatat civile dhe penale. Dënimet silleshin prej qortimeve gjyqësore deri në dënim me burg. Qëndrimet tradicionale shoqërore ndaj femrave në shoqërinë e dominuar nga meshkujt i kontribuuan shkallës së lartë të abuzimit në familje dhe numrit të vogël të rasteve të raportuara. Rrjeti i grave të Kosovës raportoi në shtator se shumë gra, nëse jo të gjitha,vareshin financiarisht nga sulmuesit e tyre.

Qeveria ndërmori masa për t'i përmirësuar të dhënat e veta mbi dhunën në familje dhe filloi zbatimin e Planit të Veprimit kundër Dhunës në Familje për periudhën 2011-14, të cilin e miratoi në vitin 2011. Agjencia për Barazi Gjinore ishte përgjegjëse për zbatimin e ndryshimeve të politikave për ta luftuar dhunën në familje, duke propozuar një koordinator vendor dhe duke i ofruar Qeverisë raporte të rregullta. Agjencitë qeveritare morën pjesë në fushata të shumta për ta zbutur dhunën në familje dhe dhunën seksuale, duke përfshirë tubimin e 8 marsit në të cilin u tha që femrat të cilat ishin sulmuar seksualisht gjatë kohës së luftës në Kosovë vazhdonin të përballeshin me diskriminim kur i pranonin sulmet.

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale e themeloi një njësi për t'u marrë vetëm me dhunën në familje. Ministria u siguroi pak përkrahje financiare OJQ-ve që drejtonin strehimore për viktima të dhunës në familje dhe të trafikimit. Ministria gjithashtu siguroi shërbime sociale përmes qendrave për mirëqenie sociale. Disa OJQ vendëse e ndërkombëtare zhvilluan aktivitete për t'u ndihmuar femrave, por ato ishin të kufizuara nga tradita e heshtjes lidhur me dhunën në familje, abuzimin seksual dhe dhunimin.

Shkolla për trajnimin e policisë ofronte kurse speciale mbi dhunën në familje dhe dhunimin.

Ngacmimi seksual: Nuk ka ligj të posaçëm kundër ngacmimit seksual, që ishte problem i rëndomtë. Organizatat për të drejtat e gruas treguan se ngacmimi seksual zakonisht ndodhte në vend të punës, por kalonte i paraportuar për shkak të frikës nga hakmarrja fizike apo përjashtimi nga puna. Vetëdijesimi publik për ngacmim seksual mbeti i ulët dhe pak raste u raportuan në polici.

Të drejtat riprodhuese: Çiftet dhe individët kanë të drejtë të vendosin lirshëm dhe me përgjegjësi mbi numrin, shpeshtësinë dhe kohën kur të kenë fëmijë dhe të kenë qasje në informata dhe mjete për të vendosur të lirë nga diskriminimi, detyrimi dhe dhuna. Ligji mbron të drejtat riprodhuese të individëve dhe çifteve, duke përfshirë të drejtën për informim dhe qasje në shërbime riprodhuese. Në praktikë, Qeveria në përgjithësi i respektoi të drejtat riprodhuese. Fondi i OKB-së për Popullatë (UNFPA) raportoi se qasja në informim dhe trajtim të shëndetit riprodhues ishte në përgjithësi e përhapur dhe e drejtë, por bashkësitë e varfra, të margjinalizuara dhe të pashkolluara shpesh kishin qasje të kufizuar në informata. Qendrat e kujdesit shëndetësor publik ofronin trajtim të kufizuar për sëmundjet seksualisht të transmetueshme.

Diskriminimi: Femrat kanë të drejta të njëjta ligjore si meshkujt, por tradicionalisht kanë status më të ulët në familje, që ndikoi në trajtimin e tyre brenda sistemit ligjor. Agjencia për Barazi Gjinore pranë Zyrës së Kryeministrit ka mandat për ta zbatuar dhe monitoruar Ligjin për barazi gjinore.

Relativisht pak femra fituan pozita udhëheqëse të nivelit të lartë në biznes, polici apo Qeveri. Femrat përbënin më pak se 30 për qind të fuqisë punëtore të Qeverisë. Sipas Agjencisë për Regjistrimin e Bizneseve, femrat posedonin më pak se 5 për qind të bizneseve të regjistruara.

Ndonëse ligji nuk bën dallim në gjini lidhur me të drejtën për ta trashëguar pronën, prona e familjes zakonisht u kalohet vetëm meshkujve. Në raste të rralla, të vejat shqiptare, posaçërisht në zonat rurale, rrezikonin ta humbnin kujdestarinë e fëmijëve të vet për shkak të një zakoni i cili kërkonte që fëmijët dhe prona t'i kaloheshin familjes së babait të ndjerë, ndërsa e veja të kthehej në familjen e saj.

Fëmijët

Regjistrimi i lindjeve: Fëmijët e fitojnë shtetësinë nga prindërit e vet apo për shkak të lindjes në vend. Sipas një studimi të UNICEF-it të vitit 2008, 14 për qind e fëmijëve romë, ashkalinj dhe egjiptianë në zonat e Kosovës me shumicë shqiptare nuk regjistroheshin kur lindnin. Në zonat e Kosovës me shumicë serbe, 5 për qind e këtyre fëmijëve nuk regjistroheshin siç duhej. Sipas UNICEF-it, mungesa e regjistrimit nuk ndikonte në mundësinë e fëmijëve për shkollim fillor apo kujdes shëndetësor, por mund të kishte ndikim negativ në qasjen në ndihma sociale.

Abuzimi i fëmijëve: Përmasat e abuzimit të fëmijëve në vend nuk diheshin, por UNICEF-i besonte që ky problem nuk raportohej sa duhej për shkak të mungesës së vetëdijesimit publik

dhe shërbimit për viktima, si dhe mundësisë së kufizuar të autoriteteve për t'i identifikuar, raportuar dhe referuar rastet e abuzimit.

Martesa e fëmijëve: Ligji lejon që personat të martohen që në moshën 16-vjeçare. Pati prova anekdotike për martesë të fëmijëve, posaçërisht ndër bashkësitë rome, ashkalike, egjiptiane dhe shqiptare. Qeveria dhe OJQ-të nuk mblodhën të dhëna për martesën e fëmijëve.

Shfrytëzimi seksual i fëmijëve: Dhunimi i të miturës është vepër penale që dënohet prej 5 – 20 vjet burg, varësisht nga rrethanat dhe mosha e viktimës. Ligji ndalon posedimin, prodhimin dhe shpërndarjen e pornografisë së fëmijëve. Personi që prodhon, përdor apo përfshin një fëmijë në krijimin apo prodhimin e pornografisë dënohet prej një deri në pesë vjet burg. Shpërndarja, promovimi, transmetimi, ofrimi apo paraqitja e pornografisë së fëmijëve dënohet prej gjashtë muaj deri në pesë vjet burg. Posedimi ose prokurimi i pornografisë së fëmijëve dënohet me të holla apo me burg deri në tri vjet.

Rrëmbimet ndërkombëtare të fëmijëve: Kosova nuk është nënshkruese e Konventës së Hagës të vitit 1980 për aspektet civile të rrëmbimit ndërkombëtar të fëmijës.

Antisemitizmi

Më pak se 100 hebrenj jetonin në vend.

Nuk pati arrestime apo zhvillime të tjera lidhur me përdhosjen në nëntor të vitit 2011 të 80 gurëve të varreve në varrezat hebraike në Prishtinë.

Trafikimi i personave

Shih *Raportin* e Departamentit të Shtetit *mbi Trafikimin e Personave* në: www.state.gov/g/tip.

Personat me aftësi të kufizuara

Kushtetuta dhe ligji ndalojnë diskriminimin e personave me aftësi të kufizuara fizike, ndijore, intelektuale dhe mendore në punësim, shkollim, transportim, qasje në kujdes shëndetësor dhe në ofrim të shërbimeve të tjera shtetërore. Ligji parashikon që Qeveria t'u ofrojë mbrojtje dhe shërbime të gjithë qytetarëve në mënyrë të barabartë, por personat me aftësi të kufizuara hasën në diskriminim të madh në praktikë. Qeveria nuk i zbatoi në mënyrë efikase ligjet dhe programet për t'u siguruar personave me aftësi të kufizuara qasje në ndërtesa, informata dhe komunikim. Edhe Zyra e Avokatit të Popullit nuk është e qasshme për personat me aftësi të kufizuara fizike. Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale është agjenci e Qeverisë që është përgjegjëse për mbrojtjen e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara.

OJQ-ja "Kosovo Mental Disability Rights International" (K-MDRI) konstatoi që Qeveria nuk e zbatonte planin e vet kombëtar të veprimit për personat me aftësi të kufizuara dhe nxori në pah

dështimet e Ministrisë së Punës që personave me aftësi të kufizuara t'ua ofronte mundësitë për t'u integruar në shoqëri.

Sipas OJQ-së vendëse për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, "HandiKos", autoritetet nuk i zbatonin në mënyrë adekuate ligjet dhe planet e Qeverisë për veprim lidhur me personat me aftësi të kufizuara. Si rrjedhojë, fëmijët me aftësi të kufizuara shpesh përjashtoheshin nga mundësitë edukative, nuk vlerësoheshin në mënyrë profesionale dhe nuk kishin qasje të mjaftueshme në shërbime shëndetësore dhe sociale.

Ligji parashikon mbrojtje për fëmijët me aftësi të kufizuara. Sipas Ministrisë së Arsimit, në Kosovë ekzistonin shtatë shkolla speciale për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe 77 klasë për fëmijë me nevoja speciale u ishin shtuar shkollave të rregullta. Ministria raportoi se në fund të vitit, 1.179 nxënës pranonin shkollim special. Sipas UNDP-së, fëmijët me aftësi të kufizuara hasnin në një sërë pengesash për t'iu qasur objekteve të arsimit të rregullt, duke përfshirë mungesën e transportit deri në objekte të arsimit dhe prapa, trajnimin e posaçëm për mësimdhënës dhe infrastrukturën përkatëse. Si rrjedhojë, vetëm 10 për qind e fëmijëve me aftësi të kufizuara regjistroheshin në shkolla të rregullta. Ministrisë së Punës i mungonin mjetet financiare dhe personeli i duhur për t'i zbatuara ligjet dhe për t'u ofruar mbështetje familjeve të fëmijëve me aftësi të kufizuara.

Asnjë ligj shtetëror nuk e rregullon procesin e dërgimit të personave në objekte të kujdesit psikiatrik ose social, apo për t'i mbrojtur të drejtat e tyre brenda institucioneve dhe objektet e shëndeti mendor nuk i plotësonin standardet. Ministria e Punës dhe Ministria e Shëndetësisë kishin mandate të ndara për trajtimin e personave që merreshin me çështje të shëndetit mendor. K-MDRI-ja dhe QKRVT-ja raportuan se policia i ndalonte personat me aftësi të kufizuara mendore pa kurrfarë baze ligjore dhe i mbante të izoluar. K-MDRI raportoi se rreth 50.000 persona me aftësi të kufizuara mendore çonin jetë të izoluar dhe të stigmatizuar jashtë institucioneve.

Objekti kryesor për personat me aftësi të kufizuara mendore ishte Instituti Special i Shtimes (ISS), një kompleks me dy ndërtesa për trajtimin e personave. Njëra ndërtesë fokusohej në të rriturit me aftësi të kufizuara zhvillimore ose intelektuale dhe trajtonte 56 persona. Ndërtesa e dytë e specializuar në trajtimin e të rriturve me probleme psikiatrike udhëhiqej nga Ministria e Shëndetësisë dhe kishte 58 persona, shumica e të cilëve jetonin aty që nga lufta e vitit 1999. Qeveria gjithashtu mbështeti disa "shtëpi riedukimi" për personat me aftësi të kufizuara zhvillimore. Të gjitha, përveç njërës, u ishin dedikuar të rriturve me aftësi të kufizuara.

K-MDRI raportoi se ISS nuk kishte staf të trajnuar sa duhet dhe citoi mungesën e programit rehabilitues për pacientë dhe banorë. Sipas QKRVT-së, kushtet në ISS nuk u përmirësuan gjatë këtij viti dhe ekzistonin pak protokolle për ndërhyrje ndaj pacientëve që tregonin agresion ndaj të tjerëve apo që mund ta lëndonin veten. Stafi i ISS-së nuk mbante shënime në të cilat përshkruheshin në hollësi sjelljet e mundshme të dëmshme të pacientëve ose llojet ose periudhat

e trajtimit. Monitoruesit vunë re mbingarkesë dhe kushte të këqija, tualete të thyera dhe që disa pacientë flinin në dhoma të vogla pa çarçafë apo batanije.

QKRVT raportoi se reparti i psikiatrisë i Shërbimit Korrektues të Kosovës nuk mund t'i trajtonte siç duhet apo t'i mbante të burgosurit me probleme emocionale apo mendore. Kjo klinikë kishte shtretër për shtatë pacientë, por nuk kishte vend të ndarë për pranimin apo trajtimin e femrave. Autoritetet i ndaluan femrat që përjetonin shqetësime psikiatrike në Qendrën Klinike Universitare në Prishtinë. Në raporte thuhej që zyrtarët i lidhnin femrat për shtrati gjatë qëndrimit të tyre.

Ministria e Shëndetësisë drejtonte tetë shtëpi për integrim dhe riedukim anembanë vendit, të cilat u ofronin shërbime të kujdesit 75 personave me aftësi të kufizuara mendore. Ministria e Punës drejtonte 10 shtëpi të tjera për riedukim me nga 10 deri në 15 banorë. K-MDRI raportoi se, ndonëse këto shtëpi ishin të menduara si të përkohshme, shumica e banorëve kaluan vite të tëra në to me pak gjasa për t'u integruar në bashkësi.

Pakicat kombëtare/raciale/etnike

Gjendja e sigurisë në veri mbeti e paparashikueshme dhe autoritetet raportuan për incidente, përfshirë eksplodime, djegie të veturave dhe shkëmbime të zjarrit. Thuhej që EULEX-i dhe KFOR-i ndërhynë për t'i penguar përleshjet ndërmjet serbëve të Kosovës dhe shqiptarëve të Kosovës. Në qershor, ekstremistët serbë sulmuan personelin e KFOR-it dhe shtinë e plagosën dy ushtarë gjermanë gjatë një operacioni për largimin e barrikadave në Rudarë.

Më 20 nëntor, rreth 100 serbë të Kosovës protestuan kundër rindërtimit të shtëpive të shqiptarëve të Kosovës në lagjen Kroi i Vitakut, ndërsa dëshmitarët pohuan që protestuesit shtinë me armë zjarri dhe një person i paidentifikuar hodhi një mjet shpërthyes në drejtim të shqiptarëve të tubuar atypari. Pas katër ditësh, persona të panjohur ua vunë zjarrin materialeve ndërtimore të grumbulluara për shtëpi. Policia nuk kishte asnjë të dyshimtë dhe nuk u raportua për të lënduar.

Në korrik, Qeveria e hapi Zyrën Administrative në Mitrovicën Veriore (ZAMV) për të ofruar shërbime publike në komunën që do të themelohet të Mitrovicës veriore. Ekstremistët serbë e konsideruan zyrën si një përpjekje tjetër të autoriteteve që në mënyrë të njëanshme ta impononinsundimin e ligjit në veri. ZAMV pranoi qindra kërkesa nga serbët e Kosovës veriore, që tregonin gatishmërinë e tyre për të bashkëpunuar me institucionet e Qeverisë.

Më 7 dhjetor, një sulmues i maskuar shtiu në katër punëtorë të ZAMV-së gjersa ishin duke dalë nga një kafene lokale dhe plagosi njërin prej tyre. Në së paku tri raste gjatë këtij viti, automjeteve të ZAMV-së ose automjeteve që u takonin punëtorëve të zyrës iu vu zjarri ose u shkatërruan. Në dhjetor, dy shpërthime ndodhën afër projekteve të mbështetura nga ZAMV-ja. Policia nuk e identifikoi asnjë të dyshuar për këto incidente.

Qeveria ndërmori një reformë për komisionin të vet për gjuhët, i cili kishte pak autoritet për ta monitoruar zbatimin e politikave për gjuhët në vend. Sipas kësaj reforme, Qeveria emëroi një komisioner për gjuhët me orar të plotë për t'i monitoruar dhe sanksionuar institucionet e Qeverisë. Qeveria gjithashtu ndërmori masa në disa nisma të tjera politike, duke përfshirë ofrimin e kurseve të gjuhës për shërbyes civilë, për ta shtuar numrin e shërbyesve civilë dygjuhësorë. Qeveria gjithashtu emëroi një komisioner në dhjetor të vitit 2012 si pjesë e përpjekjeve të saj për ta forcuar zbatimin e politikave për gjuhët.

Pakicat etnike, ku përfshiheshin bashkësia serbe, rome, ashkalike, egjiptiane, turke, boshnjake, gorane, kroate dhe malazeze, ballafaqoheshin me shkallë të ndryshme të diskriminimit institucional dhe shoqëror në fushat si punësimi, arsimi, shërbimet sociale, përdorimi i gjuhëve, liria e lëvizjes, e drejta e PZHBV-ve për t'u kthyer dhe të drejta të tjera themelore. Anëtarët e bashkësisë rome, ashkalike dhe egjiptiane vuanin nga diskriminimi i përhapur shoqëror dhe ekonomik; shpesh u mungonte qasja në higjienë themelore, kujdes mjekësor dhe shkollim; dhe vareshin me të madhe nga ndihmat humanitare për mbijetesë.

Raportet për dhunë dhe krime të tjera të drejtuara kundër pakicave dhe pronës së tyre vazhduan.

Zyrtarë qeveritarë dhe organizata ndërkombëtare shpejt dënuan vrasjen më 6 korrik të një çifti të kthyer serb, që u vranë në shtëpinë e tyre në Talinoc. Në gusht, policia ndaloi dy të dyshuar për t'i intervistuar lidhur me të shtënat, por nuk pati të arrestuar. Policia ia ricaktoi hetimin Njësisë për Krime të Rënda, përpjekjet e të cilës për zgjidhjen e rastit vazhduan në fund të vitit.

Më 13 qershor, në Mitrovicë, dy meshkuj e sulmuan atin Mitrofan, një murg ortodoks serb, i veshur në rroba të murgut. Murgu u trajtua për lëndime në kokë dhe dorë. Policia nuk qe në gjendje ta identifikonte asnjë të dyshuar.

Serbët e kthyer në Klinë përjetuan kërcënime të shumta. Më 22 maj, dy shtëpive të serbëve iu vu zjarri, njëra pronë u shkatërrua. Para zjarrit, familjet e kthyera në tetë fshatra pranuan kërcënime me shkrim nga një grup radikal që e quan veten "Armata Kombëtare Shqiptare", në të cilat familjeve u sugjerohej ta lëshonin vendin. Policia filloi hetimet, por nuk pati të arrestuar në fund të vitit. Në gusht, një pronë e një të kthyeri tjetër në Klinë u kaplua dy herë nga zjarri brenda dy ditësh. Policia lokale tha se shkaktarë të zjarrit ishin telat e rrymës në afërsi.

Shqiptarët dhe serbët e Kosovës u përleshën gjatë këtij viti dhe incidentet më të rënda ndodhën në festën serbe të Vidovdanit, më 28 qershor. Policia e Kosovës urdhëroi që autobusi me udhëtarë serbë të kthehej në Serbi pasi udhëtarët i gjuajtën me gurë dhe gojarisht i shanë zyrtarët kufitarë. Në portat e largimit, vizitorët gjuajtën koktej molotovi, shkopinj, shishe të birrës dhe gurë në policë, duke lënduar 35 policë, dy prej tyre rënd. Vizitorët gjithashtu pësuan lëndime, por nuk diheshin shifrat e sakta. Të njëjtën ditë, por në një incident tjetër, shqiptarët e Kosovës i sulmuan tre autobusë që i bartnin të rinjtë serbë në Graçanicë pas aktiviteteve të Vidovdanit afër Prishtinës. Rreth 16 fëmijë u lënduan në këtë incident në të cilin shqiptarët e Kosovës gjuajtën gurë dhe koktej molotovi në autobusë. Policia nuk arrestoi askënd për këto incidente. IPK kreu

një hetim dhe konkludoi që asnjë zyrtar policor nuk kishte bërë vepër penale; prokurori që e shqyrtoi rastin u pajtua.

Në korrik, gjykata e dënoi Naif Visoqin me 16 vjet burg pasi u deklarua fajtor për vrasjen në tetor të vitit 2011 të një serbi të Kosovës dhe plagosjen e dy të tjerëve në komunën e Istogut.

Punësimi i pakicave në institucione publike mbeti i kufizuar dhe në përgjithësi kufizohej në nivele më të ulëta të Qeverisë. Qeveria nuk pati mekanizma efektivë për monitorimin e niveleve të punësimit të pakicave në institucione publike.

Ligji kërkon kushte të barabarta për nxënës, pavarësisht nga gjuha amtare dhe parashikon të drejtën për shkollim publik në gjuhën amtare për nxënës të pakicave, deri në mbarim të shkollës së mesme. Megjithatë, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe organizatat ndërkombëtare raportuan që shkalla e regjistrimit në shkollë ishte më e ulët ndër bashkësitë pakicë jo-serbe (ashkalinj, boshnjakë egjiptianë, goranë, romë, turq dhe të tjerë) dhe *Raporti i Progresit për Kosovën për vitin 2011* i Komisionit Evropian vërejti pak përmirësim në qasje në shkollim për bashkësitë pakicë. *Raporti* i UNDP-së *për Zhvillim Njerëzor në Kosovë 2010* konkludoi se pothuaj të gjithë fëmijët shqiptarë dhe serbë ishin regjistruar në shkolla fillore, kurse vetëm 77 për qind e fëmijëve të grupeve të tjera etnike ishin regjistruar. Fëmijët romë, ashkalinj dhe egjiptianë i vijonin mësimet në shkolla të përziera me fëmijët shqiptarë dhe serbë të Kosovës dhe thuhej se përballeshin me kërcënim dhe ngacmim në disa zona me shumicë shqiptare. Fëmijët romë ishin më të prapambetur për shkak të varfërisë, gjë që i shtyri shumë prej tyre ta braktisnin shkollën dhe të fillonin të punonin në moshë të re për të kontribuar në të ardhurat e familjes.

Abuzimet shoqërore, diskriminimi dhe aktet e dhunës të bazuara në orientim seksual dhe identitet gjinor

Kushtetuta dhe ligji ndalojnë diskriminimin e bazuar në orientim seksual.

Nuk pati diskriminim zyrtar në punësim, strehim, në të qenët pa shtetësi, në qasje në shkollim apo kujdes shëndetësor; megjithatë, presioni shoqëror e detyroi pjesën më të madhe të LHBT-ve që ta fshihnin orientimin e tyre seksual apo identitetin e tyre gjinor. Megjithatë, OJQ-të raportuan që diskriminimi i drejtuar ndaj LHBT-ve ekzistonte, por shpesh kalonte pa u raportuar. OJQ-të gjithashtu theksuan se materialet e Qeverisë me të cilën mbështeteshin të drejtat e njeriut dhe praktikat jodiskriminuese shpesh nuk i përmendnin të drejtat e LHBT-ve, madje edhe kur materialet i përmendnin qartazi të gjitha grupet e tjera të mbrojtura.

Libertas Kosovo, një OJQ vendëse që u ofron strehim emergjent dhe këshilla LHBT-ve, pohoi që shumica e LHBT-ve nuk e tregonin publikisht orientimin e tyre seksual për shkak të frikës nga izolimi shoqëror, diskriminimi në punësim apo mospranimi nga familjet e tyre. Gjatë këtij viti, Libertas regjistroi raste që personave LHBT u mohohej qasja në takime shoqërore për shkak të

paragjykimeve personale të pronarëve ose për shkak se lokalet supozonin se po të identifikoheshin si "miqësore për homoseksualë", kjo do ta dëmtonte jetesën e tyre.

Më 16 dhjetor, persona të panjohur sulmuan aktivistët LHBT që ishin tubuar për ta diskutuar dhunën fizike të kohëve të fundit me rastin e përurimit të revistës *Kosova 2.0*. Sulmuesit i ngacmuan të pranishmit për shkak të orientimit të tyre seksual. Rreth shtatë persona i sulmuan nga pusia anëtarët e Libertasit dhe të Qendrës për emancipim shoqëror gjersa ishin duke hyrë në zyrat e OJQ-së. Disa persona pësuan lëndime të lehta. Anëtarët e tjerë të Libertasit i penguan sulmuesit për të mos hyrë në OJQ, por jo para se sulmuesit ta dëmtonin pronën dhe ta hidhnin një cilindër të mbushur me gaz të panjohur në ndërtesë. Policia u përgjigj me kohë dhe e përfshiu hetimin e këtij rasti në task forcën që e themeloi pas dhunës së 14 dhjetorit. Asnjë sulmues nuk ishte arrestuar apo identifikuar deri në fund të vitit. Libertasi u dëbua nga objekti pas incidentit dhe aktivistët e Libertasit ngelën pa vend për takim apo strehim në fund të vitit.

Qendra për Zhvillimin e Grupeve Shoqërore (QZHGSH), një OJQ vendëse e fokusuar në çështjet shëndetësore të LHBT-ëve, raportoi se LHBT-ët në përgjithësi ndjeheshin të pasigurt dhe shumë prej tyre raportonin kërcënime për sigurinë e tyre personale. Individët e kërcënuar rrallë parashtronin ankesa pranë autoriteteve për shkak të njollës që i bashkëngjitej homoseksualizmit. QZHGSH gjithashtu theksoi se viktimat në përgjithësi refuzonin ta lejonin QZHGSH-në që t'i paraqiste rastet e tyre publikisht apo t'ua paraqiste ato autoriteteve për shkak të frikës nga diskriminimi. Ndonëse QZHGSH nuk haste në pengesa të dukshme për punën e vet, presioni shoqëror dhe qëndrimet tradicionale ndikuan në kufizimin e veprimtarive të saj.

Dhuna apo diskriminimi tjetër shoqëror

Ndonëse nuk pati raportime të konfirmuara për diskriminim zyrtar të personave me HIV/AIDS gjatë këtij viti, pati raportime anekdotike se diskriminimi i tillë kishte ndodhur. Personat me HIV/AIDS, që vareshin nga Ministria e Shëndetësisë për barëra, kaluan muaj të tërë pa barëra pasi zyrtarët e EULEX-it i arrestuan shumë zyrtarë të Ministrisë për korrupsion.

Seksioni 7. Të drejtat e punëtorëve

a. Liria e asociimit dhe e drejta për të negociuar kolektivisht

Ligji u lejon punëtorëve të formojnë dhe t'u bashkohen sindikatave të pavarura që ata i zgjedhin, pa autorizim paraprak ose kërkesa të tepërta. Ligji e njeh të drejtën për të bërë grevë. Ligji u lejon sindikatave t'i zhvillojnë veprimtaritë e veta pa ndërhyrje. Ligji parashikon të drejtën për t'u organizuar dhe negociuar kolektivisht pa ndërhyrje apo kufizim dhe këto ligje në përgjithësi u respektuan në praktikë. Rregulloret e Qeverisë e ndalojnë diskriminimin antisindikal.

Qeveria nuk e kufizoi të drejtën për t'u organizuar dhe negociuar kolektivisht dhe u lejoi sindikatave t'i zhvillonin veprimtaritë, duke përfshirë grevat, pa ndërhyrje.

Në përgjithësi, Qeveria e respektoi të drejtën për të formuar dhe për t'iu bashkuar sindikatave. Të dhëna anekdotike pohonin që kompanitë private i kërcënonin punëtorët e vet kur u bashkoheshin apo themelonin sindikata. Inspektorati i punës raportoi se gjatë këtij viti nuk kishte marrë asnjë ankesë për diskriminim të punëtorëve që ishin përpjekur t'u bashkoheshin sindikatave. Disa zyrtarë të sindikatës raportuan për diskriminim antisindikal në praktikë. Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Kosovës (BSPK) dhe Konfederata e Sindikatave të Lira raportuan se pak kompani i respektonin rregulloret që ndalonin diskriminimin antisindikal. Sindikatat gjithashtu pohonin që të drejtat e punëtorëve abuzoheshin në çdo sektor nga punëdhënësi, duke përfshirë organizatat ndërkombëtare, ku personeli gjoja nuk merrte pension.

b. Ndalimi i punës së dhunshme apo të detyruar

Ligji i ndalon të gjitha format e punës së dhunshme apo të detyruar. Qeveria nuk e zbatoi në mënyrë efektive këtë ligj. Qeveria nganjëherë i përfshinte përpjekjet për ta ngritur vetëdijesimin për punën e dhunshme apo të detyruar në përpjekjet e veta kundër trafikimit. Qeveria sponsorizoi një fushatë dymujore në vjeshtë për ta ngritur vetëdijesimin publik për punën e dhunshme apo të detyruar me theks të veçantë në format më të këqija të punës së fëmijës dhe shfrytëzimit të punës së fëmijës. Puna e dhunshme apo e detyruar ndodhte dhe fëmijët shpesh detyroheshin të kërkonin lëmoshë. Në dhjetor, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale koordinoi punën me disa komuna në një pilot program për ta bërë një studim mbi lypjen e lëmoshës dhe kushtet e jetesës së personave që detyroheshin të kërkonin lëmoshë.

Shih gjithashtu *Raportin e* Departamentit të Shtetit *mbi Trafikimin e Personave* në: www.state.gov/g/tip.

c. Ndalimi i punës së fëmijës dhe mosha minimale për punësim

Ligji i lejon fëmijët të punojnë në moshën 15-vjeçare nëse puna e tillë nuk është e dëmshme për fëmijën apo nuk e pengon atë për ta vijuar mësimin. Mosha minimale ligjore për cilëndo punë që mund ta rrezikojë shëndetin, sigurinë apo moralin e të rinjve është 18 vjet.

Rregulloret e ndalojnë shfrytëzimin e fëmijëve në vend të punës, duke përfshirë ndalimin e punës së dhunshme apo të detyruar; Qeveria e mbështeti një task forcë kundër trafikimit për të ndërhyrë në raste të punës së dhunshme apo të rrezikshme dhe filloi të ndërhynte në raste të tilla, por shpesh ishte e kufizuar për shkak të burimeve të kufizuara.

Puna e fëmijës mbeti problem. Sipas UNICEF-it, të dhëna anekdotike sugjerojnë që numri i fëmijëve që kërkonin lëmoshë në rrugët e qyteteve dhe qytezave shënoi rritje viteve të fundit, ndonëse numri i përgjithshëm i fëmijëve lypës mbeti i panjohur. Ndërsa shumica e fëmijëve nuk ishin fituesit kryesorë të të ardhurave të familjes, puna e fëmijës shërbente si ndihmë e madhe për disa familje.

Në zonat rurale, fëmijët e rinj zakonisht u ndihmonin familjeve të veta në punë bujqësore. Fëmijët e qytetit shpesh punonin në një sërë punësh jozyrtare të shitjes me pakicë, si shitja e gazetave, cigareve dhe kartelave të telefonit në rrugë dhe në ndërtimtari. Disa fëmijë gjithashtu merreshin me punë fizike, si transportimi i mallrave. OJQ-të ndërkombëtare, që ishin aktive në vend, vazhduan të raportonin për shkelje të punës së fëmijës gjatë këtij viti.

Ministria e Punës i koordinoi politikat e Qeverisë për mbrojtjen e fëmijës dhe Instituti i sapothemeluar për politika sociale menaxhoi zbatimin e ligjeve për punën e fëmijës. Ministria themeloi një sistem për monitorimin e incidenteve të punës së fëmijës në komuna dhe menjëherë i njoftoi punëdhënësit për rastet ku përfshihej puna e rrezikshme e të miturve.

Shih gjithashtu *Konkluzionet e* Departamentit të Punës *mbi format më të këqija të punës së fëmijës* në: www.dol.gov/ilab/programs/ocft/tda.htm.

e. Kushtet e pranueshme të punës

Rroga minimale kombëtare ishte 170 euro ($224) në muaj, me një ndryshim të vogël në disa sektorë.

Ligji parashikon javën standarde të punës prej 40 orësh; kufizon numrin e orëve të rregullta të punës deri në 12 orë në ditë; kufizon punën jashtë orarit deri në 20 orë në javë dhe 40 orë në muaj; kërkon pagimin e bonusit për punën jashtë orarit; dhe ndalon punën e tepërt e të detyrueshme jashtë orarit. Ligji parashikon 20 ditë pushim me pagesë në vit për punëtorë dhe deri në 12 muaj për pushim të lehonisë.

Gjatë këtij viti, punëdhënësit shpesh dështonin t'i respektonin standardet zyrtare të punës për shkak të mungesës së mbikëqyrjes qeveritare dhe zbatimit, posaçërisht lidhur me javën standarde të punës dhe punën e detyrueshme e të papaguar jashtë orarit. OJQ-të raportonin se punëtorët shpesh nuk i raportonin shkeljet e tilla për shkak të frikës nga reprezaljet. Sipas BSPK-së, shumë individë punonin me orar të gjatë në sektorin privat, kinse sipas dëshirës së punëtorëve, pa kontratë pune, pa pagesë të rregullt apo kontribute pensionale të paguara në emër të tyre. Punëtorët raportonin se përjashtoheshin nga puna pa arsye dhe në kundërshtim me ligjet në fuqi dhe se u mohoheshin festat. Organizatat për të drejtat e gruas treguan se ngacmimi seksual ndodhte në vend të punës, por kalonte i paraportuar për shkak të frikës për përjashtim nga puna apo për hakmarrje fizike. Sipas zyrtarëve të sindikatës, punëtorët në sektorin publik zakonisht përballeshin me keqtrajtim të ngjashëm, duke përfshirë ngacmimin seksual dhe humbjen e vendit të punës për shkak të lidhjes me parti politike.

Inspektorati i punës në kuadër të Ministrisë së Punës është përgjegjës për zbatimin e standardeve të punës, shëndetit dhe sigurisë. 50 inspektorët e Inspektoratit të punës kryen 7.074 inspektime gjatë këtij viti, i këshilluan punëdhënësit dhe shqiptuan 1.886 vërejtje për shkelje të ndryshme të standardeve të punës. Inspektorët zakonisht ua jepnin punëdhënësve 3-5 ditë kohë për t'i

korrigjuar shkeljet para se t'ua shqiptonin gjobat. Gjatë të njëjtës periudhë, inspektorati shqiptoi 157 gjoba.

Ndonëse ligji parashikon mbrojtje të shëndetit të punëtorëve dhe të kushteve të tyre të punës, shumë institucione private dhe publike nuk e respektonin atë. Zyrtarët e Inspektoratit të punës raportuan për vështirësi në marrjen e informatave të sakta pasi punëtorët rrallë i zbulonin problemet vetë, edhe përkundër mbrojtjeve ligjore. Ministria e Punës raportoi për 17 fatalitete në vend të punës dhe 45 aksidente të rënda në vend të punës gjatë këtij viti.